

VENDIM
"Ne Emer te Republikes"

Gjykata e Rrethit Gjyqesor Tirane e perbere prej:

GJYQTAR: Petrit ÇOMO
GJYQTAR: Ibrahim HOXHA
GJYQTARE: Alkelina GAZIDEDE

Asistuar nga sekretaria gjyqesore Entela SH.. me pjesmarrien e prokurorit Ardian BRAHO, sot, ne daten 23.05.2012, ne Tirane, mori ne shqyrtim ne seance gjyqesore publike çeshtjen penale Nr. 751 Akti, ne ngarkim te te pandehurve:

1- A.SH: i biri i (.....) dhe i (.....), dtl. (.....), lindur ne (.....), banues ne Tirane, Rr. “(.....)”, P(.....), me vendbanim te perkohshem Lagja (.....) 3, Athine, Greqi, i martuar me tre femije, i padenuar, me kombesi e shtetesi shqiptare, gjykuar ne gjendje te lire, perfaqesuar ne gjykim nga av. Shefqet Dizdari, me licence nr. 389, me prokure te posaçme nr.464 Prot., dt. 28.02.2012, te konsullit shqiptar ne Athine, Greqi, Alfred Sotiri.

2- S.SH: i biri i (.....) dhe i (.....), dtl. (.....), lindur dhe banues ne (.....), me vendbanim te perkohshem Lagja (.....)Rr. (.....) me arsim te mesem, i padenuar, me kombesi e shtetesi shqiptare, gjykuar ne gjendje te lire, perfaqesuar ne gjykim nga av. Shefqet Dizdari, me licence nr. 389, me prokure te posaçme nr.464 Prot., dt. 28.02.2012, te konsullit shqiptar ne Athine, Greqi, Alfred Sotiri.

3- C.M: i biri i (.....) dhe i (.....), dtl. (.....), lindur ne (.....)(.....), banues ne Tirane, Rruga “(.....)”,(.....), pallat (.....)kati i (.....)i martuar me dy femije, me arsim te mesem, i padenuar, me kombesi e shtetesi shqiptare, gjykuar ne gjendje te lire, perfaqesuar ne gjykim nga av. Shefqet Dizdari, me licence nr. 389, me deklarim ne seance gjyqesore.

4- F.Z: i biri i (.....) dhe i (.....), dtl. (.....), lindur dhe banues ne (.....), i martuar me dy femije, me arsim te mesem, i padenuar, me kombesi e shtetesi shqiptare, gjykuar ne gjendje te lire, perfaqesuar ne gjykim nga av. Shefqet Dizdari, me licence nr. 389, me deklarim ne seance gjyqesore.

AKUZUAR: Per vepren penale te pastrimit te produkteve te vepres penale, kryer ne bashkepunim, parashikuar nga neni 287 - 25 i Kodit Penal.

Gjykata pasi pranoi kerkesen e te pandehurve per gjykim te shkurtuar, mori provat, degjoi prokurorin Ardian Braho, i cili ne diskutimin perfundimtar kerkoi deklarimin fajtor te

te pandehurve A.SH, S.SH, C.M e F.Z per veprën penale të pastrimit të produkteve të veprës penale, kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 287-25 të Kodit Penal dhe denimin e tyre respektivisht: A.SH me 6 vjet burgim dhe 1500000 leke gjobe, S.SH me 6 vjet burgim dhe 1500000 leke gjobe, C.M me 5 vjet burgim dhe 800000 leke gjobe dhe F.Z me 5 vjet burgim dhe 800000 leke gjobe, avokatin Shefqet Dizdari, i cili kerkoi deklarinim të pafajshëm të te pandehurve A.SH, S.SH, C.M e F.Z, në bazë të nenit 388/1/a të KPPenale, të pandehurit A.SH, S.SH, nuk u paraqiten në gjykim me vullnetin e tyre, ndërsa të pandehurit C.M e F.Z, nuk u paraqiten në seancat e fundit, si e shqyrtoi çështjen në teresi:

VEREN

Se Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë ka filluar ndaj të pandehurve A.SH, S.SH, C.M e F.Z procedimin penal Nr. 1927, viti 2011, duke i akuzuar ata për veprën penale të pastrimit të produkteve të veprës penale, kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 287-25 i Kodit Penal dhe pasi ka perfunduar hetimet e ka sjelle çështjen për gjykim.

Në seancë gjyqësore të pandehurit C.M e F.Z kerkuan gjykim të shkurtuar, në bazë të nenit 403 të KPPenale. Avokati Shefqet Dizdari në emër të të pandehurve A.SH dhe S.SH (kete të drejte ia kanë dhënë të pandehurit me prokuror të posaçme) kerkoi gjykim të shkurtuar në bazë të nenit 403 të KPPenale.

Prokurori ishte dakord me kete kerkese të të pandehurve.

Gjykata pasi e pranoi kerkesen e të pandehurve në bazë të nenit 404 të KPPenale, zhvilloi gjykimin sipas kerkësive të nenit 405 të KPPenale, duke u bazuar në gjendjen që janë aktet.

Nga shqyrtimi gjyqësor rezultoi se të pandehurve A e S.SH, të cilet janë vellezer, prej vitesh jetojnë në qytetin e Athinës, në Greqi. Të dy këta persona dyshohen nga organet kompetente greke se në bashkëpunim edhe me persona të tjere, kanë kryer veprimtari të kunderligjshme në Greqi. Sipas këtyre dyshimeve vellezerit SH. kishin organizuar dhe drejtuar një organizatë kriminale, e cila kishte në përberje rreth 20 shofere dhe 20 prostituta. Kjo organizatë merrej me shfrytëzimin e prostitucionit. Femrat me kombesi jo shqiptare, të pandehurit i kontaktonin nëpërmjet një agjencie pune në Rusi. Të pandehurit kishin krijuar një zyre takimesh, të ashtequajtura erotike, e cila kishte të publikuar në gazeta të ndryshme, greke numrat e telefonit. Klientet komunikonin në këto numra me operatore të ndryshëm të cilet punonin për zyren, në ambiente të ndryshme. Operatorët, pasi merrnin adresën e klientit, komunikonin me shoferet e taksive dhe prostitutat, të cilet kishin pike takimi të perdritshëm. Një shofer merrte gjithmone një prostitute dhe e çonte në vendin e takimit erotik, që në fakt kishte të bente me kryerje të marrëdhëniesh seksuale jashtë dëshirës së femrave dhe ku çmimi për çdo takim erotik ishte rreth 150 euro. Pas mbarimit të takimit shoferi merrte perseri prostitutën, e cila merrte shpërblimin e saj 20-30 euro. Shoferi merrte shpërblimin e tij 20-30 euro, ndërsa pjesën tjetër e dorezonte tek një shtetas grek edhe ky shofer taksie, ose tek bashkeortaku i të pandehurve SH., shtetas grek. Të gjithë këta persona ia dorezonin fitimet të pandehurit S.SH. Me këto të ardhura të pandehurit SH. kishin krijuar një shoqëri lundrimi, argetimi. Ata kishin blere pese skafe me vela, të cilet i perdornin edhe si vende për takimet erotike. Sipas akuzës kjo veprimtari ka filluar përpara vitit 2006 e ka vazhduar deri në muajin maj të vitit 2009.

Në lidhje me veprimtarinë e kunderligjshme të të pandehurve SH. në Greqi, autoritetet e drejtesisë greke, shërbimet e policisë, si dhe Prokuroria, kanë kryer hetime që përpara vitit 2006. Nga materiali i ardhur nga autoritetet e drejtesisë greke, në ekzekutim të leterporosise, rezultoi se në muajin mars të vitit 2006 në Athinë është vrare me armë zjarri

nje shtetas grek, brenda ambienteve te nje banese. Ne banese pas vrasjes eshte gjetur nje shtetas tjetër grek, pronari i baneses, i cili kishte qene me viktimen gjate gjithë mbremjes. Gjate mbremjes pronari i baneses i kishte kerkuar mikut te tij, qe ti telefonin nje zyre ne Athine, e cila ofronte takime erotike ne dukje, por qe ne realitet ofronte prostituta kundrejt shperblimit prej 150 euro. Kete numer kishin perdorur edhe here te tjera per takime te tjera. Pasi kane komunikuar me nje shtetase greke, i kane kerkuar dy prostituta per ti çuar ne banesen e tyre. Pas gjysme ore ne banese kane ardhur dy prostituta, te cilat nuk jane prezantuar me emra, apo nese ishin greke apo te huaja. Ne banese ne momentin kur kane ardhur prostitutat, kane qene vetem pronari i baneses dhe viktima. Pasi kane konsumuar pije alkolike dhe kane kryer marrdhenie seksuale, njera nga prostitutat eshte larguar, ndersa tjetra me kembenguljen e viktimes ka qendruar. Viktima gjate gjithë mbremjes ka qene i armatosur me nje arme zjarri, te cilen e mbante sipas rastit ne dore apo mbi tavoline, duke luajtur me te. Ne nje nga keto raste viktima eshte qelluar me arme zjarri dhe ka vdekur. Duke u nisur nga numri telefonik celular, nga i cili eshte telefonuar zyra, eshte bere i mundur komunikimi me kete numer nga sherbimet e policise greke. Pasi jane porositur dy prostituta nga sherbimet e policise, nepermjet nje procesi te simuluar veprimesh, eshte bere shoqerimi per ne rajonin e policise i dy prostitutave, njera me origjine rumune dhe tjetra me origjine shqiptare. Krahas me prostitutat jane ndaluar edhe dy shofere taksie, te cilet shoqeronin dy prostitutat, njeri me origjine nga Sudani dhe tjetri me origjine nga Bullgaria. Nisur nga numrat telefonike celulare, qe perdornin shoferet, eshte arritur qe te identifikohesh njera nga te ashtuquajturat operatore e zyres, nje shtetase greke. Nga deklarimi i kesaj shtetaseje ka rezultuar se punen e mesiperme e ka gjetur nga njoftimi ne nje nga gazetate e njoftimeve. Per kete zyre ka punuar qe nga janari i vitit 2006. Nga deklarimi eshte mesuar edhe vendndodhja e zyres. Ajo kishte disa numra telefonike celulare, qe ishin numra te njoftimeve ne gazeta. Gjithashtu ajo kishte nje numer, ne te cilin kishte te shenuar disa numra telefonike celulare te prostitutave dhe te shofereve. Kur njeri nga klientet merrte tek njeri nga numrat dhe linte vendin e takimit, ajo merrte shoferin dhe prostituten, si dhe i tregonte vendin ku do te shkonte. Kur vajza mbaronte pune shoferi e merrte ne telefon. Parate per punen qe bente i gjente ne zyre çdo te shtune ose te diele. Gjate deklarimit kjo shtetase fillimisht eshte shprehur se nuk e dinte se kush ishte pronar i zyres, por nga operatorja tjetër, qe ishte me origjine ruse, kishte marre dijeni qe e kishte emrin A.. Ajo eshte shprehur se nuk e kishte pare dhe nuk e kishte takuar ndonjehere kete person, pasi kjo perbente metode sigurie per te veshtiresuar percaktimin e vendndodhjes. Gjate deklarimit te saj kjo shtetase ka deklaruar ne lidhje me numrat telefonike celulare, qe jane gjetur te regjistruar ne telefonin e saj celular, ku njeri nga numrat perdorej nga personi i identifikuar nga ajo me emrin A. SH., shqiptar dhe shoku i saj, si dhe i bashkeshortit te saj. Ajo ka njohur nepermjet fotografise te pandehurin A.SHn, si shokun e saj A. SH.. Ne lidhje me ngjarjen e vrasjes ajo ka deklaruar se nuk ka qene ne pune naten e vrasjes, por ka qene operatorja tjetër me origjine ruse. Ka qene kjo shtetase, e cila i ka treguar per emrin e prostitutes, si dhe per naten e vrasjes. Kjo shtetase ka deklaruar se mesa kishte dijeni, pronar i zyres per te cilen ajo kishte punuar deri ne ate moment ishte shtetasi A. SH.. Per kete zyre punonin 8 prostituta dhe 8 shofere. Te dhenat e mesiperme, sipas akuzes provojne faktin se veprimtaria e paligjshme e te pakten te pandehurit A.SHt kishte filluar me heret se viti 2006.

Ne muajin prill, te vitit 2009 sherbimet e policise te sektorit kunder shfrytezimit te prostitucionit ne qytetin e Athines, ne Greqi, kane pasur informacione qe dy vellezerit shqiptare, te pandehurit A dhe S.SH, te pakten qe prej vitit 2006 ishin drejtues te nje organizate, e cila kishte ne perberje rreth 20 shofere, greke dhe te huaj, si dhe 20 prostituta, kryesisht te kombesise te huaj, ruse, ukrainase, rumune dhe shqiptare, si dhe qe merrej me shfrytezim te prostitucionit. Femrat me origjine sllave i kontaktonin nepermjet nje agjencie pune ne Rusi. Menyra si funksiononte organizata eshte pershkruar me lart.

Nisur nga keto informacione, nga sherbimet e policise greke, ne fillim te muajit prill te vitit 2009, jane organizuar vezhgimet e lokalit, si dhe te personave ku mendohej qe ushtrohej veprimtaria kriminale. Vezhgimi fillonte gjithmone nga nje lokal ku jane mbajtur te dhenat ne lidhje me automjetet, personat shofere qe drejtonin keto automjete, si dhe femrat qe hipnin ne keto mjete. Vezhgimi vazhdonte duke ndjekur mjetet dhe kthimin e tyre ne lokalit ku kishte filluar vezhgimi. Nga veprimet hetimore te kryera ne Greqi, rezultoi se jane vene re disa raste kur shoferet dorezonin para tek nje shofer, shtetas grek, i cili me vone ia dorezonte te pandehurit S.SH. Nga vezhgimi jane identifikuar disa nga shoferet qe kane qene me kombesi shqiptare, greke, rumune.

Nga sherbimet e policise gjyqesore ne date 19.05.2009 jane organizuar ne dy raste takime erotike te kontrolluara, ku kliente kane qene dy oficere policie te sektorit te siperpermendur. Keshtu eshte komunikuar me telefon celular ne njerin nga numrat e publikuar ne gazete dhe eshte lene takimi ne nje hotel. Ne dhomen e hotelit jane paraqitur dy prostitutat, te cilet kane thene se vinin nga zyra dhe kerkonin nje shume prej 150 euro paradhenie. Ne keto momente eshte bere ndalimi i prostitutave, njera me kombesi ruse dhe tjetra me kombesi shqiptare, si dhe i dy shofereve me kombesi shqiptare. Pas ndalimit te personave te mesiperme eshte bere ndalimi i shofereve te tjere, se bashku me disa femra. Nga deklarimi i 2 prostitutave rezultoi se kane degjuar nga shoferet se pronari i zyres ishte nje person me emrin A.

Nga materiali hetimor rezultoi te jene ndaluar 11 shofere taksie, nder ta kater shtetas shqiptare, nje rumun dhe te tjeret me kombesi greke. Nga materiali hetimor, gjithashtu rezultoi te jene identifikuar 5 prostituta, dy nga te cilat i referohen deklarimeve te shofereve per emrin A. si pronar i zyres. Nder 5 prostitutat vetem 2 jane akuzuar per vepren penale te parashikuar nga Kodi Penal Grek, te ngjashme me vepren penale ushtrimi i prostitucionit.

Nga materiali hetimor rezulton te jene ndaluar dy bashkeortaket e te pandehureve SH., si dhe nje shofer grek. Ata akuzohen per shfrytezim te prostitucionit ndaj 37 femrave, kryesisht me origjine dhe kombesi te ish republikave sovjetike. Ne ngarkim te te pandehureve te mesiperme eshte ngritur edhe akuza e pastrimit te parave nepermjet krijimit te shoqerive, si dhe blerjes te skafeve. Nga materiali hetimor rezulton se i pandehuri S.SH rreth viteve 2006-2007 ka blere tre skafe, per nje vlere prej 1000000 euro. Nga veprimet hetimore ka rezultuar se rreth fundit te vitit 2006 dhe fillimi i vitit 2007 njeri nga bashkeortaket e te pandehureve SH. dhe njekohesisht i bashkepandehur ne procedimin penal te zhvilluar ne Greqi, ne cilesine e keshilltarit administrativ te shoqerise anonime "Shoqeria anonime e rrugeve lundruese te anijeve argetuese", ka kryer disa procedura per tre skafe qe ishin ne pronesi te kesaj shoqerie. Ne vitin 2008 te pandehurit SH., si dhe nje shtetas grek se bashku me bashkeshorten, kane krijuar nje shoqeri me emrin "Rruget lundruese", me nje kapital 2500000 euro, me qellimin per te blere skafet e shoqerise "Shoqeria anonime e rrugeve lundruese te anijeve argetuese". 51% te kapitalit do ti kishin shtetasit greke. Shoqeria ekzistuese ka qene nje shoqeri e formuar ne realitet nga te pandehurit SH. dhe e administruar nga shtetas grek, pasi per shtetasit shqiptare ligji grek nuk lejon pronesine. Nje gje e tille eshte bere me qellimin qe te krijohet shoqeria, pasi nuk lejohej krijimi i nje shoqerie nga shtetas jogrek. Ne kete shoqeri shtetasi grek, qe luante rolin e keshilltarit administrativ, ne shoqerine e pare luante rolin e ekonomistit.

Nga bilancet e vitit 2007 shoqeria ka bere nje xhiro ne shumen prej 236736 euro dhe fitimet paraqiten ne shumen prej 54807 euro. Ne bilancin e vitit 2008 shoqeria ka patur nje fitim prej 408805 euro.

Nga materiali hetimor rezulton se autoritetet greke te hetimit kane regjistruar nje procedim penal ne ngarkim te pandehureve A dhe S.SH, si dhe te disa shtetasve shqiptare dhe te huaj per veprat penale qe u permenden me lart. Nga materiali hetimor rezultoi se autoritetet

greke te hetimit kane bashkuar dhe po hetojne, ne kuader te nje procedimi penal te bashkuar, dy procedime penale. Procedimi penal i pare ka pasur objekt te hetimit nje ngjarje te muajit mars te vitit 2006, ndersa procedimi penal i dyte ka pasur objekt nje ngjarje te muajve prill-maj te vitit 2009. Objekt i hetimit ne te dy rastet ka qene veprimtaria e kunderligjshme e te pandehureve A.SH dhe S.SHt.

Rezulton se te ardhurat qe vinin nga ushtrimi i veprimtarise te kunderligjshme qe kryenin ne Greqi te pandehurit SH., keta te fundit filluan ti investonin ne Greqi dhe ne Shqiperi. Ne Greqi krijuan dhe administruan shoqerine e lundrimeve, ndersa ne Shqiperi investuan ne blerjen e pasurive te paluajtshme dhe krijimin e shoqerive tregtare. Nje karakteristike e veprimtarise te kunderligjshme te te pandehurve SH. ne drejtim te pastrimit te parave, produkt te krimit te shfrytezimit te prostitucionit, ka te beje pikerisht me transfertat dhe levizjet e vazhdueshme te vlerave monetare nga Greqia per ne Shqiperi dhe anasjelltas, gjithmone ne funksion te perdorimit dhe venies ne qarkullim te produkteve te vepres penale, apo per te ndihmuar ne kryerjen e veprimtarise te kunderligjshme.

Rezulton se duke filluar te pakten qe prej fillimit te vitit 2005, deri ne muajin Maj te vitit 2009, te pandehurit A dhe S.SH, te ndihmuar edhe nga te pandehurit C.M dhe F.Z, ne menyre te vazhdueshme dhe te panderprere, kane transferuar dhe transformuar shuma te konsiderueshme ne vlera monetare nga Greqia ne territorin e Republikes se Shqiperise dhe anasjelltas.

Ne daten 30.12.2004 i pandehuri A.SH ka blere nje siperfaqe toke prej 1500 metra katrore, si dhe nje ndertese me siperfaqe prej 150 metra katrore, ne shumen prej 2000000 leke ne fshatin Muçaj, Vore, Tirane. Ne daten 31.12.2004 i pandehuri A.SH ka blere nje siperfaqe toke prej 2600 metra katrore ne fshatin Muçaj, Vore, Tirane, ne shumen prej 3800000 leke.

Ne daten 14.01.2005 i pandehuri A.SH ka çelur llogarine e pare bankare ne euro ne banken “Intesa Sanpaolo” me nr.(.....), me depozitim fillestar 200 euro. Ne daten 17.01.2005 ne kete llogari bankare eshte bere kalimi i nje shume prej 11980 euro nga nje shtetas grek (ortaku i tij ne Greqi, i marre me vone ne cilesine e te pandehurit), per te pandehurin A.SHn me pershkrimin “dhurate”. Ne kete llogari bankare i pandehuri A.SH ka realizuar transaksione te ndryshme financiare. Transaksionet jane kryer nga e ema e te pandehurit, prej 50000 euro ne daten 15.03.2006. Keto depozitime jane kaluar ne llogarine e te pandehurit ne Greqi. Transaksioni i fundit ne kete llogari eshte i dates 03.01.2008 ne shumen prej 13000 euro. Ky transaksion ka sherbyer per te çelur ne daten 03.01.2008 nje llogari tjeter ne euro.

Ne daten 27.01.2005 ne Gjykatën e Rrethit Gjyqesor, Tirane, i pandehuri A.SH ka regjistruar shoqerine “SH.”, ku ka qene ortak dhe administrator i kesaj shoqerie. Kjo shoqeri ka qene subjekt tatimor i deges se tatimeve Tirane me NIPT K 51613032 E. Objekt i veprimtarise se shoqerise ka qene tregti me pakice dhe shumice karburantesh, bar-kafe, import dhe eksport mallrash te ndryshem. Nga provat, kryesisht bilancet, rezulton se ky aktivitet eshte deklaruar me humbje. Aktualisht pika e karburantit te kesaj shoqerie mban siglen e shoqerise “Taçi Oil”, dhene me qera.

Ne daten 11.08.2005 i pandehuri A.SH ka celur nje llogari bankare ne leke, me numer nr(.....). Ne kete llogari bankare eshte depozituar fillimisht shuma prej 1078900 leke leke. Kjo llogari eshte perdorur vetem per terheqje ne shuma te vogla.

Ne daten 08.11.2005 i pandehuri A.SH ka çelur nje llogari te dyte ne euro ne banken “Intesa Sanpaolo”, me numer nr.(.....), me depozitim fillestar 2000 euro. Ne kete depozite jane kryer veprime financiare, kryesisht depozitime ne kesh nga i pandehuri, nga e ema dhe i ati i te pandehurit. Depozitimet, qe kane filluar ne daten 08.11.2005, deri ne daten 26.09.2006, jane te natyres se depozitimeve ne kesh, mbledhja e ketyre depozitave dhe me

pas kalimi i vlerave monetare ne drejtim te Greqise ne shumen prej 100000 euro perfundimisht ne daten 26.09.2006.

Ne daten 17.05.2006 i pandehuri A.SH ka çelur nje llogari bankare ne USD (dollare amerikane) me numer nr.(.....), me depozitim fillestar prej 960 USD (dollare amerikane) dhe gjendja aktuale eshte 967. Ne kete llogari nuk jane kryer veprime.

Ne daten 27.09.2006 ne llogarine e dyte bankare ne euro, me numer nr.(.....), ka nje depozitim prej 200000 euro, ne nje depozite me afat kater mujor. Ne kete llogari bankare i pandehuri ka realizuar disa depozitime ne kesh, duke nisur nga data 26.12.2006, deri ne daten 29.01.2007. Ne daten 30.01.2007 shuma prej 250000 euro, duke perfshire depozitimet, si dhe te ardhurat nga llogaria bankare, eshte kaluar ne depozite me afat maturimi nje-vjeçar.

Ne daten 17.01.2007 i pandehuri S.SH ka kerkuar ne Gjykatën e Rrethit Gjyqësor, Berat, regjistrimin si person fizik per ushtrimin e aktivitetit ekonomik te tregtimit me pakice te karburanteve, njekohesisht si subjekt tatimor ne zyren e tatim-taksave ne komunën Kutalli, te rrethit Berat, me NIPT K 72721002 C. Ky aktivitet rezulton i mbyllur ne vitin 2007. Ne daten 24.12.2008 eshte aplikuar per çregjistrimin e personit fizik dhe ne daten 19.02.2009 eshte bere çregjistrimi.

Ne daten 19.07.2007 i pandehuri A.SH ka çelur nje llogari te trete bankare, me nje depozite prej 500000 euro. Kjo eshte nje depozite me afat nje vjeçar, qe ka gjeneruar vlera monetare nga maturimi deri ne vitin 2009, duke arritur ne shumen prej 533000 euro, e cila perben edhe gjendjen e kesaj llogarie ne momentin e sekuestrimit.

Ne daten 03.01.2008 i pandehuri A.SH ka çelur nje llogari te katert bankare ne euro me numer nr.(.....), me depozitim fillestar ne shumen prej 13000 euro, shume e marre nga llogaria e pare ne euro.

Ne daten 09.01.2008 te pandehurit S.SH dhe F.Z kane çelur nje llogari bankare ne euro me numer nr.(.....) ne banken “Intesa San Paolo” ne shumen prej 500000 euro. Kjo shume eshte vendosur ne depozite nje vjecare e cila pas maturimit ne daten 09.01.2009 eshte vendosur serish ne depozite nje vjeçare me afat maturimi, date 11.01.2010. Kjo llogari bankare ka si depozitues te pandehurin S.SH, i cili ka deklaruar si burim te te ardhurave aktivitetin e tij tregtar dhe eshte ne cilesine e mbajtesit te pare te llogarise. Ne cilesine e mbajtesit te dyte te llogarise eshte i pandehuri F.Z. Ne momentin e sekuestrimit gjendja e kesaj llogarie bankare ka qene ne shumen rreth 500000 euro.

Ne daten 30.04.2008 i pandehuri C.M ka çelur llogarine e pare bankare ne euro ne banken “Alfa Bank”, me numer (.....). Ne kete llogari i pandehuri C.M ka kryer disa transaksione, depozitime dhe me pas transferime, ne shumet prej 10000 euro, ne drejtim te disa shtetaseve te huaja femra ne qytetin e Athines, Greqi. Gjithashtu ne kete llogari eshte bere transferimi nga nje shtetas ne shumen prej 80000 euro, ku si burim eshte deklaruar kapar per blerjen e nje toke dhe nje karburanti ne autostrade, km 11, ne Muçaj, Vore, pikerisht karburanti ne emer te te pandehurit A.SH. Ne momentin e sekuestrimit gjendja e kesaj llogarie ka qene ne shumen 80000 euro.

Ne daten 04.02.2009 i pandehuri A.SH ne llogarine e dyte bankare ne euro me numer(.....), ka depozituar nje shume 214000 euro.

Ne daten 05.02.2009 i pandehuri A.SH ne llogarine e katert bankare ne euro, me numer (.....), ka depozituar nje shume prej 1000000 euro me nje afat maturimi nje vjeçar. Per kete transaksion, si burim per shumen 450000 euro, i pandehuri A.SH ka deklaruar nje hua te marre nga i pandehuri C.M, burri i motres se tij. Per kete arsye eshte paraqitur nje kontrate huaje e dates 06.02.2009. Afati i shlyerjes se shumes ka qene brenda nje viti.

Ne daten 23.02.2009 i pandehuri A.SH, ne llogarine e dyte bankare ne euro me numer (.....), te gjithë shumen prej 501585 euro, shume e mbledhur nga dy transfertat e

permendura me siper, e ka kaluar si depozite me afat nje mujor. Ne momentin e sekuestrimit gjendja ne llogarine e dyte bankare ka qene 507271 euro.

Ne daten 20.05.2009, ne llogarine e katert bankare ne euro me numer (.....), mbi bazen e kerkeses se te pandehurit A.SH, eshte kryer transferimi ne drejtim te llogarise te pandehurit C.M te shumes 500000 euro, kalim me pershkrimin “kthim te borxhit”. Ne momentin e sekuestrimit gjendja ne llogarine e katert bankare ka qene ne shumen 525671 euro.

Ne daten 20.05.2009 i pandehuri C.M ka çelur nje llogari bankare ne euro ne banken “Intesa San Paolo” me numer nr.(.....), ku ka nje transakcion te vetem po ne kete date ne shumen 500000 euro, ku si burim eshte paraqitur kthimi i borxhit nga i pandehuri A.SH.

Rezulton se i pandehuri C.M eshte regjistruar si subjekt tatimor i deges se tatimeve Tirane ne fushen e “Sherbimeve telefonike”, ne daten 10.04.2008, me NIPT K 81610029 N. Ky subjekt eshte vetedeklaruar si biznes i vogel dhe aktualisht eshte aktivitet i mbyllur. I pandehuri F.Z figuron i regjistruar ne degen e tatimeve, Berat, si subjekt tatimor me NIPT K82629002. Objekt i veprimtarise eshte ushtrimi i aktivitetit ne fushen e serave per mbjellje perimesh dhe dru frutore dhe eshte i regjistruar ne daten 29.02.2008, ku statusi eshte aktiv.

Nga bisedat e pergjuara telefonike ka rezultuar se i pandehuri C.M, menjehere pas regjistrimit te procedimit penal, ka komunikuar vazhdimisht me te pandehurin A.SH. Gjithashtu i pandehuri komunikonte edhe me te pandehurin F.Z. Nga keto biseda ka rezultuar se te pandehurit SH. ndodheshin ne Greqi. Ne kete moment kohor te pandehurit kishin filluar qe te krijonin alibine e tyre ne lidhje me veprat penale per te cilat po hetoheshin ne Greqi. Me keshillimin e avokatit te tyre mbrojtës ne Greqi, i pandehuri A i ka kerkuar ndihme kryesisht te pandehurit C., qe te mundahej te kryente veprime, te cilat te justifikonin te ardhurat monetare. Keto veprime do te kryheshin kryesisht ne fshatin e tyre te lindjes ne Berat. Per kete arsye i pandehuri A i ka kerkuar qe te pergatiste foto te ndryshme te tokave me te mbjella ne pronesi te tyre, kryesisht bostane, portokalle e tjera. Per kete i ka kerkuar qe te perpilonte kontrata qeraje fiktive me fshatare te ndryshem, te fotografonte fshatare te ndryshem qe punonin ne toka me rroge, mjete bujqesore te marra nga fshatare te ndryshem. Keto dokumente, kontrata, si dhe fotografi, duhej te noterizoheshin. Per kete qellim angazhoheshin edhe i pandehuri F.Z dhe shtetasi A SH., babai i te pandehurit. Gjithashtu i pandehuri A i ka kerkuar te pandehurit C., qe te mundesonin qe karburanti i ndodhur ne Vore, me siglen “Taçi Oil” te figuronte ne emrin e tij. Per kete qellim ai i ka kerkuar te pandehurit C. te takohej me shtetasin R.T, apo me administratorin e ketij te fundit, me qellim qe keta te fundit te dilnin deshmitare ne Greqi. Nga ana tjetër i ka kerkuar qe te benin edhe fotografi te montuara, ku sigla “Taçi Oil” te zevendesohet me siglen e firmes “SH.”, te fotografonte punetore te ndryshem me bluza me mbishkrimin e firmes “SH.”, te cilet punonin ne kete karburant, me qellim qe te vertetohej fakti qe ky karburant ishte akoma ne pronesi te te pandehurit A dhe nxirrte te ardhura. I pandehuri A i ka kerkuar C. qe te kryente te gjithë keto veprime dhe te nxirrte nga keto aktivitete, duke falsifikuar edhe kontrata qeraje te paqena, apo edhe shifra te fryra, nje shume fitimi ne muaj prej 50000 euro. Nje pjese e ketyre dokumenteve eshte dorezuar ne Greqi nepermjet shofereve te autobuzeve te linjes Shqiperi-Greqi dhe jane bere pjese e procedimit penal te regjistruar ne Greqi.

Sipas prokurorit, duke analizuar provat e administruara ne seance gjyqesore, rezulton e provuar se te pandehurit A.SH dhe S.SH, ne bashkepunim dhe me ndihmen e te pandehureve C.M dhe F.Z, kane konsumuar elementet e vepres penale te “Pastrimit te produkteve te vepres penale”, parashikuar nga neni 287-25 i K.Penal, pasi me dashje, duke ditur apo duhet te kishin supozuar, kane transferuar dhe transformuar produkte te vepres penale me qellim fshehjen e burimit dhe natyres te pasurise (vlerave monetare), si dhe me qellim fshehjen dhe mbulimin e origjines se pasurise, per te shmangur pasojat e vepres

penale. Kuptimi i vepres penale te parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal, eshte i lidhur ngushte me kuptimin qe parashikon per pastrimin e produktit te vepres penale Konventa e Keshillit te Evropes per Pastrimin, Depistimin, Sekuestrimin dhe Konfiskimin e Produkteve te Krimit dhe Financimit te Terrorizimit, Varshave, date 16.05.2005, ratifikuar nga Parlamenti Shqiptar me ligjin nr.9646, date 27.11.2006. Per nga hierarkia zbatuese Konventa e mesiperme eshte primare mbi ligjin e brendshem. Ne mbeshtetje te Konventes te mesiperme, doktrines evropiane, si dhe kuptimit te nenit 287 te KPenal, objekti i vepres penale ka te beje me ato marredhenie juridike te cilat rregullojne marredheniet ekonomike te tregut te lire, te konkurences te lire, te lirive dhe te drejtave te njeriut ne aspektin e sigurise dhe rendit publik, ne aspektin ekonomik, shkelja e te cilave sjell qe shume faktore sociale dhe ekonomike te jene ne rrezik.

Gjithnje sipas prokurorit, kur flitet per vepren penale te parashikuar nga neni 287 i KPenal, duhet te kihet parasysh nje bashkevendosje, jo domosdoshmerisht e provuar ne menyre te drejperdrejte, te anes objektive dhe anes subjektive te vepres penale, nje bashkevendosje, jo domosdoshmerisht e provuar ne menyre te drejperdrejte, ne mes vepres penale kryesore apo te quajtur ndryshe krimi fillestar dhe veprimeve qe perbejne pastrim te parave, kur fitimi i paligjshem eshte perdorur si baze per nje investim, nje aktivitet tregtar apo qofte per nje transferte bankare. Per nga vete natyra specifike e krimi te parashikuar nga neni 287 i KPenal, ne cilesine e nje krimi te pavarur dhe te lidhur me nje krim tjeter, duke patur gjithmone mbeshtetje ne Konventen e mesiperme, nje element i rendesishem per percaktimin e figures se vepres penale eshte provueshmeria, qe vepra penale kryesore apo krimi fillestar ekziston dhe te gjitha pasurite qe rrjedhin nga kjo veper apo ky krim mund te jene objekt i nje vepre penale te pastrimit te parave. Pra mjafton qe te provohet ne menyre te pakundershtueshme qe vepra penale kryesore apo krimi fillestar eshte kryer, nje veprimtari e kunderligjshme dhe e denueshme eshte kryer, por nuk eshte e nevojshme qe te kemi nje vendim gjykate per kete krim fillestar. Elementi i krimi fillestar apo i vepres penale kryesore, jo domosdoshmerisht presupozon ekzistencen e nje vendimi gjyqesor te pakundershtueshem te meparshem, madje doktrina gjyqesore evropiane, e mbeshtetur ne Konventen e mesiperme, nuk konsideron te rendesishem edhe identifikimin e autoreve te krimi fillestar. Nje element i anes objektive te kryerjes te vepres penale te parashikuar nga neni 287 i KPenal, ngushtesisht i lidhur me anen subjektive, eshte edhe origjina e paligjshme e pasurise. Natyrisht qe nisur nga natyra e vepres penale te parashikuar nga neni 287 i KPenal, ne cilesine e nje krimi te pavarur dhe te lidhur me nje krim tjeter, rendesi ne procesin e te provuarit paraqesin indiciet apo provat rrethanore, ku me te zakonshmet te perdorura per keto lloj veprash penale jane: rendesia e shumes se pastruar; lidhja qe kane personat qe merren me pastrimin e parave me aktivite te paligjshme apo me njerez te perfshire ne keto aktivite; rritja e pasurise ne menyre te pazakonshme apo te papritur; natyra dhe karakteristikat e transaksioneve financiare apo ekonomike, si: perdorimi i nje sasie te madhe te parave kesh; mungesa e nje justifikimi te ligjshem te te ardhurave per te realizuar transaksione financiare; mungesa apo justifikime te pabazuara mbi origjinen e ligjshme te transaksioneve financiare; kryerja e operacioneve financiare apo tregtare ne menyre te parregullt; depozitimi i parave ne banka ne menyre te copezuar, e cila nuk i pergjigjet nje dinamike te arsyeshme; hapja e llogarive bankare te njepasneshme ne intervale te shkurtra e te tjera. Pra ne procesin e te provuarit, ne rastin e pastrimit te produkteve te vepres penale, nuk duhet domosdoshmerisht, si ne rastin e veprave te tjera penale, provueshmeria drejtperdrejt e lidhjes ne mes vepres penale kryesore apo krimi fillestar dhe produktit te kesaj vepre penale. Mjafton qe nisur edhe nga provat rrethanore te konkludojme per ekzistencen e krimi fillestar; te konkludojme ne lidhje me mundesine e nxjerrjes dhe ekzistences te nje produkti kriminal nga krimi fillestar; te konkludojme ne lidhje me nje mekanizem te krijimit te nje pasurie te ashtuquajtur te

ligjshme, nga veprime te cilat perbejne pastrim te produkteve te vepres penale dhe te shprehur ne ligj; te konkludojme ne lidhje me origjinen e paligjshme te pasurise te ardhur nga veprime te cilat perbejne pastrim te produkteve te vepres penale dhe te shprehur ne ligj; te konkludojme ne lidhje me pamjaftueshmerine apo justifikime te pabazuara mbi origjinen e pasurise.

Persa me siper, gjithnje sipas prokurorit, duhet qe ne kushtet e perdorimit ne procesin e te provuarit te provave rrethanore apo indicieve, keto te jene te rendesishme, te sakta, ne perputhje me njera-tjetren, ku ne teresine e tyre ato te nxjerrin ekzistencen e nje fakti kriminal, qe ne rastin tone ka te beje me krimin fillestar dhe pastrimin e produktit te kimit fillestar.

Ne lidhje me personat e trete subjekte te vepres penale, te parashikuar nga neni 287 i KPenal, duke perjashtuar subjektet e konsideruar vetepastrues apo subjektet qe kane kryer krimin fillestar, ne procesin e te provuarit eshte e domosdoshme qe te vertetohen veprime te kunderligjshme te kryera me qellim fshehjen apo maskimin e origjines se paligjshme te produkteve, apo ndihma qe u jepet autoreve te kimit fillestar, per tu ikur pasojave ligjore te veprimeve te tyre.

Pra ne lidhje me kategorine e personave te trete, subjekte te vepres penale te parashikuar nga neni 287 i KPenal, nuk kerkohet njohuri e percaktuar mbi ekzistencen e kimit fillestar, por mjafton te ekzistojte vetedija apo te prezumohet dijenia ne lidhje me transaksione financiare jo normale, te cilat te bejne te mundur te arrihet ne nje konkluzion te arsyeshem qe produkti ka rrjedhur nga nje veper penale.

Sipas prokurorit provohet ekzistenca e nje vepre penale te denueshme (shfrytezimi i prostitucionit) veper penale e cila ne gjithe shtrirjen e saj ka si qellim nxjerrjen e perfitimeve monetare. Ekzistenca e veprimeve te kunderligjshme te te pandehureve A dhe S.SH, si dhe shtrirja kohore e kryerjes se ketyre veprimeve te kunderligjshme. Ekzistenca e nje produkti kriminal te nxjerre nga vepra penale e shfrytezimit te prostitucionit (pagesa prej 150 euro per çdo takim “erotik” dhe shperndarja e fitimit). Ekzistenca e mekanizimit te pastrimit te produkteve te vepres penale (transferimi i produkteve te vepres penale ne sistemin bankar dhe ne disa raste transformimi i produkteve te vepres penale ne pasuri te paluajtshme apo kapitale per ngritjen e biznesve ne Greqi apo Shqiperi). Ekzistenca e origjines te paligjshme te pasurise (transfertave bankare, depozitave bankare, blerja e pasurive te paluajtshme apo te luajtshme ne Greqi apo Shqiperi). Krijimi i pasurive te sipercituara nga viti 2005 deri ne vitin 2009 pa patur shpjegim financiar; rritja e pasurise ne menyre te pazakonshme apo te papritur brenda nje periudhe kohore te shkurter; transfertat bankare te cilat kane si karakteristike perdorimin e nje sasie te madhe te parave kesh, mungesen e nje justifikimi te ligjshem te te ardhurave per te realizuar transaksionet bankare, mungesa apo justifikime te pabazuara mbi origjinen e ligjshme te transaksioneve bankare, kryerja e transaksioneve bankare ne menyre te parregullt, depozitimi i parave ne banka ne menyre te copezuar, e cila nuk i pergjigjet nje dinamike te arsyeshme, hapja e llogarive bankare te njepasnjeshme ne intervale te shkurtra. Ekzistenca e pamjaftueshmerise apo justifikimi pa prova i origjines se pasurise te ardhur nga veprime te cilat perbejne pastrim te produkteve te vepres penale. Bisedat e pergjuara telefonike te te pandehurit A.SH ne lidhje me perpjekjet per te mundesuar ligjerimin e te ardhurave te investuara ne Greqi apo te depozituara ne banka ne Shqiperi. Ekzistenca e veprime te kunderligjshme te kryera nga te pandehurit C.M dhe F.Z, me qellim fshehjen apo maskimin e origjines se paligjshme te produkteve, si dhe ndihma qe u eshte dhene te pandehureve SH. per tu ikur pasojave ligjore te veprimeve te tyre. Permendim ketu hapjen e dy llogarive bankare nga i pandehuri C.M, llogari bankare te cilat kane funksionuar vetem ne interes te pastrimit te produkteve te vepres penale nga i pandehuri A.SH; perfshirjen ne llogarine bankare ne emer te pandehurit S.SH, ne cilesine e mbajtesit te dyte, te te pandehurit

F.Z. Ekzistenca e dijenise apo mundesise per te patur dijeni nga ana e te pandehurve C.M dhe F.Z, ne lidhje me origjinen e vlerave monetare qe keta te pandehur kane transferuar, apo kane mbajtur ne llogarite e tyre bankare ne emer te tyre, si pasuri te tyre. Nga bisedat e pergjuara telefonike, rezulton angazhimi i te pandehureve per te mundesuar ligjerimin e te ardhurave te investuara ne Greqi apo te depozituara ne banke ne Shqiperi nga te pandehurit SH., perpjekja per te justifikuar te ardhurat nga krimi edhe gjate hetimit dhe gjykimit.

Prokurori e bazon akuzen e tij ne provat shkresore, te cilat ndodhen ne fashikull dhe u moren ne seancen gjyqesore, tek pergjimet, si dhe ne deklarimet e marra gjate hetimeve paraprake.

Prokurori, ne lidhje me llojin dhe masen e denimit kerkoi nga Gjykata qe per çdo te pandehur te mbaje parasysh dhe te vleresoje rrezikshmerine e vepres penale; pasojat e vepres penale ne ekonomine e vendit dhe ne jetegjatesine e krimit fillestar; rrezikshmerine e te pandehurve, duke patur parasysh ketu edhe vepren penale kryesore; rolin e gjithsecilit nga te pandehurit; qendrimin e te pandehureve ndaj akuzes. Ne perfundim te gjykimit prokurori, duke i konsideruar akuzat te provuara plotesisht gjate gjykimit, kerkoi denimin e te pandehurve me llojit dhe masat e denimit te permendura me lart.

Te pandehurit nuk e pranuan akuzen. Avokati e filloi mbrojtjen me diskutimin ligjor teorik qe ka te beje me kuptimin e nenit 287, pastrimin e produkteve te vepres penale dhe me pas vazhdoi me kundershtrimet per provat e sjella nga Prokurori.

Sipas mbrojtjes prokurori ne diskutimin e tij eshte perpjekur te shpjegoje qe ekziston lidhje e ngushte ne mes kuptimit te vepres penale te parashikuar ne nenin 287 i Kodit Penal, me kuptimin qe parashikon per pastrimin e produktit te vepres penale Konventa e Keshillit te Europes per Pastrimin, Depistimin, Sekuestrimin dhe Konfiskimin e Produkteve te Krimit dhe Financimit te Terrorizimit, Varshave, date 16.05.2005, ratifikuar nga Parlamenti Shqiptar me ligjin nr. 9646, date 27.11.2006.

Duke ndjekur logjiken e mesiperme Prokurori ka vijuar me pas duke e konsideruar vepren penale te parashikuar nga neni 287 si nje bashkevendosje, jo domosdoshmerisht te provuar ne menyre te drejtperdrejte, te anes objektive dhe anes subjektive te vepres penale; si nje bashkevendosje, jo domosdoshmerisht te provuar ne menyre te drejtperdrejte, ne mes vepres penale kryesore apo te quajtur ndryshe krimit fillestar dhe veprimeve qe perbejne pastrim te parave.

Prokurori ne diskutimin e tij shprehet se element i rendesishem per percaktimin e figures se vepres penale eshte provueshmeria qe vepra penale kryesore apo krimi fillestar ekziston dhe te gjitha pasurite qe rrjedhin nga kjo veper apo ky krim mund te jene objekt i nje vepre penale te pastrimit te parave. Sipas prokurorit mjafton te provohet ne menyre te pakundershtueshme qe vepra penale kryesore apo krimi fillestar eshte kryer, nje veprimtari e kunderligjshme dhe e denueshme eshte kryer, por nuk eshte e nevojshme qe te kemi nje vendim gjykate per kete krim fillestar, duke mos e konsideruar te rendesishem edhe identifikimin e autoreve te krimit fillestar.

Mbrojtja ndan te njejtin mendim te shprehur nga prokurori per parashikimin dhe perkufizimin pothuajse te njejte te vepres penale te parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal Shqiptar me ate te parashikuar ne Konventen Europiane te Varshaves, por ajo per te cilen kundershton jane termat qe prokurori perdor ne menyre abuzive, jo te drejte dhe te pambeshtetur ne ligjin e shkruar penal dhe ne Konventen e Varshaves, e si rrjedhoje prokurori gabon ne trajtimin teorik dhe praktik te çeshtjes penale objekt i shqyrtimit gjyqesor.

Prokurori permend rendom termat “veper penale”, “krim fillestar”, “lidhje jo e drejtperdrejte ne provimin e krimit fillestar me produktin e pastruar”, apo “mospasja e nje vendimi Gjykate per denimin e krimit fillestar nuk perben kusht per pasjen e nje krimi te pastrimit te parave”.

Ne nenin 287 te Kodit Penal Shqiptar, por edhe ne Konventen e Varshaves thuhet shprehimisht per: “pastrim te produkteve te vepres penale”. Atehere cila veper penale provohet se eshte kryer, ku eshte kryer dhe nga kush eshte kryer? Vetem pasi te kemi nje vendim gjyqesor te formes se prere, qe provon se eshte kryer vepra penale, prokurorit i lind e drejta formale per ngritjen e nje akuze te tille, nderkohe qe prokuroria djallezisht shkeput akuzen e “Pastrimit te produkteve te vepres penale” nga vete ekzistenca e nje vepre penale.

Ne nenin 36 te Kodit Penal eshte shprehur dhe percaktuar qarte termi: “Konfiskimi i mjeteve te kryerjes se vepres penale dhe produkteve te vepres penale”. Ne piken 3 te ketij neni percaktohet qarte edhe nje element tjetër i rendesishem, ai i vleresimit dhe ndarjes se pasurise qe eshte produkt i vepres penale, me pasurine tjetër te vene ne menyre te ligjshme, ku theksohet: “nese produktet e vepres penale jane bashkuar me pasuri te vena ne rruge te ligjshme, keto te fundit konfiskohen deri ne vleren e produkteve te vepres penale” apo, siç theksohet ne piken 1, germa “ç” te po ketij neni, “te çdo pasurie tjetër, vlere e se ciles i korrespondon asaj te produkteve te vepres penale”.

Ne kuptim dhe zbatim te ketij neni shprehet qarte lidhja e ekzistences se vepres penale me masat per konfiskimin e pasurise qe rrjedh vetem nga vepra penale, duke e ndare kete te fundit me pasurine e vene ne menyre te ligjshme.

Ne rastin konkret nuk provohet as ekzistenca e kryerjes se vepres penale nga kater te akuzuarit, si dhe as pjesa e pasurise se krijuar qe buron nga kryerja e vepres penale.

Siç provohet nga provat qe ndodhen ne fashikull te kater te akuzuarit zoterojne edhe pasuri te tjera te konsiderueshme. Atehere ne ç’menyre e ka bere vleresimin dhe ndarjen e kesaj pasurie Prokuroria? Cila pjese eshte produkt i vepres penale dhe cila jo?

Gjithnje sipas mbrojtjes, ne jurisprudencen shqiptare, duke perfshire mendimin akademik dhe praktiken gjyqesore, eshte pranuar qe produkt i vepres penale eshte çdo lloj pasurie, dokumentet ose instrumentet ligjore qe vertetojne tituj ose interesa te tjere ne pasurine qe rrjedh ose fitohet drejtperdrejt ose terthorazi nga kryerja e vepres penale (neni 36 i Kodit Penal). Konventa e Varshaves percakton qarte qe produkt i vepres penale nenkupton çdo avantazh ekonomik te nxjerre nga vepra penale, ku perfshihen pasuri te cdo natyre, fizike ose jofizike, te luajtshme apo te paluajtshme, si dhe aktet juridike ose dokumentet qe vertetojne nje titull ose interes mbi kete pasuri (neni 1/ “a” i Konventes se Varshaves). Pra siç vihet re te dy aktet ligjore kane te njejtin kuptim persa i perket produktit te vepres penale.

Ne te dy keto akte ligjore permendet termi “produkt i ardhur nga vepra penale”. Mbrojtja thekson se ne asnje nga keto akte ligjore nuk gjendet i shkruar apo i nenkuptuar termi i perdorur nga Prokurori “krim fillestar” apo “aktivitet kriminal i paligjshem”. Jurisprudenca shqiptare, ajo akademike apo praktika gjyqesore, ka percaktuar qarte se me veper penale do te konsiderohet nje veprim apo sjellje njerezore, i kunderligjshem, i cili me ligj eshte parashikuar si veper penale dhe qe te quhet i tille duhet te kete te dallueshem kater elementet si objektin, anen objektive, subjektin dhe anen subjektive. Eshte pranuar tashme ne jurisprudence se mungesa e njerit nga keta elemente do te sillte si pasoje mungesen e vete vepres penale. Edhe ne Konventen e Varshaves ndeshet termi “veper penale kryesore”, e cila nenkupton çdo veper penale, e cila ka sjelle produkte (neni 1 / “e” i Konventes se Varshaves). Pra edhe legjislacioni shqiptar edhe Konventa e Varshaves kerkojne patjeter ekzistencen e nje vepre penale.

Sipas mbrojtjes qe nje person te akuzohet dhe me pas te gjykohet per vepren penale te parashikuar nga neni 287, duhet te kete kryer nje veper penale (e konsideruar nga te gjitha aktet ligjore te cituar me siper si veper penale kryesore), e cila te kete dukshem te provueshem te gjithë elementet e nje vepre penale, e cila ka prodhuar nje produkt (pasuri te

llojit te permendur me lart), i cili eshte i percaktueshem dhe i dallueshem, i cili nepermjet menyrove te ndryshme eshte futur ne qarkullimin civil legal te pasurive.

Nuk qendron pretendimi i prokurorit se mjafton te provohet ekzistenca e krimit fillestar te denueshem nga ligji penal, madje edhe ne mungese te nje vendimi gjykate denimi per krimin fillestar, duke mos e konsideruar te rendesishem edhe identifikimin e autoreve te krimit fillestar. Kjo do te thote shkelje e nje prej parimeve themelore te Kodit te Procedures Penale, qe perben njerin nga te drejtat e te pandehurve, siç eshte prezumimi i pafajesise (neni 4 i Kodit te Procedures Penale), ku i pandehuri prezumohet i pafajshem, gjersa nuk vertetohet fajesia e tij me vendim gjyqesor te forms se prere. Te pandehurit A dhe S.SH aktualisht akuzohen per vepren penale te shfytzezimit te prostitucionit dhe pastrimit te parave qe burojne nga ky aktivitet ne shtetin e Greqise. Prokurori gjate gjykimit dhe diskutimit perfundimtar pretendoi se shumtat ne llogarite bankare jane rrjedhoje e aktivitetit kriminal te zhvilluar ne Greqi, duke prezumuar keshtu fajesine e tyre per vepren penale per te cilen akuzohen, duke u mohuar keshtu nje proces te rregullt ligjor.

Nuk qendron as pretendimi i prokurorit se ne procesin e te provuarit te vepres penale te parashikuar nga neni 287, ka rendesi konkludimi ne lidhje me origjinen e paligjshme te pasurise te ardhur nga veprime, te cilat perbejne pastrim te produkteve te vepres penale, apo konkludimi ne lidhje me pamjaftueshmerine, apo justifikime te pabazuara mbi origjinen e pasurise. Kjo do te thote keqinterpretim apo zbatim i gabuar i legjislacionit ne fuqi. Natyrisht qe mosjustifikimi i pasurise nga burime te ligjshme perben nje prove ne procesin e gjykimit, por kjo prove duhet te jete e lidhur ngushte me vepren penale kryesore ku barra e proves i takon Prokurorit. Prezumimi i fajesis se te pandehurit vetem mbi bazen e pamjaftueshmerise, apo justifikimit te pabazuar te origjines te pasurise, bie ndesh me procesin e çmuarjes se proves, ku çdo prove nuk ka vlere te paracaktuar. Provat merren ne teresine e tyre dhe ekzistenca e faktit nuk mund te nxirret nga indiciet, perveçse kur keto jane te rendesishme, te sakta dhe ne perputhje me njera-tjetren.

Avokati theksoi se gjykimi penal ka per objekt gjykimin e te pandehurve, te cilet akuzohen per kryerjen e veprave penale te parashikuara ne Kodin Penal. Gjykimi penal zhvillohet mbi parime dhe rregulla te percaktuara qarte ne Kodin e Procedures Penale, te cilat kane te bejne me subjektet ne gjykim, provat, menytrat e marrjes se tyre, shqyrtimin gjyqesor e te tjera, ku barra e proves i bie prokurorit. Edhe ne gjykimin e te pandehurve te akuzuar per vepren penale te parashikuar nga neni 287 i KPenal, gjykimi ndjek rregullat e permendura me siper, ku jo me pak te rendesishmit jane parimi i prezumimit te pafajesise dhe marrja e provave. Permenden keta dy elemente, pasi pretendimet e prokurorit mbeshteten ne logjiken e dyshimit te arsyeshem, ekzistenca e elementeve te vepres penale, si dhe ne mosmarrjen parasysh te nje vendimi gjyqesor te formes se prere per vertetimin e fajesis se te pandehurit. Fajesia e te pandehurit ne procesin penal nuk bazohet mbi dyshimet, pasi çdo dyshim çmohet ne favor te pandehurit.

Pra, sipas prokurorit mjafton qe gjate gjykimit penal te provohet qe i pandehuri akuzohet per kryerjen e nje vepre penale dhe qe kemi nje pasuri e cila ka nje origjine te dyshimte e jo te justifikuar ligjerisht dhe rrjedhimisht i pandehuri akuzohet per pastrim te produkteve te ardhura nga vepra penale, megjithese nuk eshte provuar e as gjykuar vete ekzistenca e vepres penale.

Avokati kujton prokurorin se jemi ne nje gjykim penal, ku çdo gje ka nje shkak dhe nje pasoje; ku çdo veper penale ka nje produkt te vetin te percaktuar; ku Gjykata ne perfundim te shqyrtimit gjyqesor eshte institucioni i vetem, i cili vendos perfundimisht nese vepra penale ekziston dhe ka elementet e duhur per tu quajtur e tille, nese i pandehuri eshte fajtor per kryerjen e vepres penale, si dhe nese produkti i ardhur nga vepra penale duhet te konfiskohet. Ne rast se nje person deklarohet i pafajshem me vendim Gjykate, atehere pasuria e tij nuk i

nenshtrohet konfiskimit sipas nenit 36 te Kodit Penal, kjo pasi çdo veper penale ka produktin e vet. Pothuajse te gjitha veprat penale te parashikuara ne dispozitat e Kodit Penal, kryhen duke u nisur nga motive te perfitim material apo monetar. Si rrjedhoje çdo veper penale ka produktin e saj, ku pas nxjerrjes te ketij produkti me qellim per te nxjerre te mira materiale, i pandehuri mundohet nepermjet mekanizmave te ndryshem qe ta hedhe ne qarkullimin legal te pasurive.

Pikerisht duke mbajtur parasysh se ne gjykimin penal eshte e domosdoshme lidhja shkak dhe pasoje; lidhja veper penale dhe produkt; deklarimi fajtor i te pandehurit per kryerjen e vepres penale dhe konfiskim i pasurise; me qellim per te shmangur nje procedure penale ne konfiskimin e pasurise, ne legjislacionin shqiptar eshte parashikuar ligji nr.10192, date 03.12.2009, per parandalimin dhe goditjen e krimit te organizuar dhe trafikimit nepermjet masave parandaluese kunder pasurise. Ky ligj perben nje perjashtim nga rregulli mbi te drejten e pronesise te personit dhe kjo per nje kategori te caktuar veprash penale te konsideruara nga ligji per nga pasojat, si me rendesi ne jeten e shoqerise shqiptare.

Ligji i mesiperm ka karakter parandalues dhe jo te denimit penal. Ky ligj zbatohet ndaj pasurive te personave te dyshuar per kryerjen e nje kategorie veprash penale, ku dyshimi bazohet ne inidicie. Ky ligj nuk ka per qellim denimin e personave per kryerje te veprave penale. Hetimi dhe gjykimi sipas ketij ligji plotesohet nga rregullat e Kodit te Procedures Civile dhe barra e proves bie edhe mbi personin e dyshuar, pronar i pasurise apo posedues i saj. Sekuestrimi dhe konfiskimi i pasurive sipas ketij ligji eshte autonom, por kur kemi te bejme me ekzistencen e nje zhvillimi procedimi penal ndaj sekuestrimit apo konfiskimit te bere sipas Kodit te Procedures Penale apo Kodit Penal, pritet dhenia e nje vendimi gjyqesor penal per revokimin apo shuarjen e ketyre masave.

Te gjitha pretendimet e prokurorit per nje pavaresi ne mes vepres penale kryesore dhe pasurise te ardhur nga vepra penale, sipas mbrojtjes do te ishin mese miri objekt i shqyrtimit te ligjit te mesiperm.

Sipas avokatit perderisa nuk provohet nepermjet nje vendimi gjyqesor te formes se prere ekzistenca e nje vepre penale, si dhe fajesia e te pandehurit, natyrisht qe behet e pamundur, duke mos patur mundesi per te provuar mundesine e krijimit te produktit te vepres penale edhe ekzistenca e dijenise apo mundesise per te patur dijeni te personave te trete ne lidhje me origjinen e pasurise qe rrjedh nga vepra penale, sic kurse eshte rasti konkret per pandehurit F.Z dhe C.M.

Avokati permendi edhe ndryshimin qe eshte bere ne nenin 287, me ligjin nr. 23, date 01.03.2012, Per disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin nr. 7895, date 27.01.1995 "Per Kodin Penal te Republikes se Shqiperise", neni 37. Avokati theksoi se ndryshimi qe i eshte bere nenit 287 ne permbajtjen e tij, indirekt ka pranuar aresyetimin e bere me siper per diskutimin mbi fajesine e te pandehurit, nisur nga koncepti i vepres penale kryesore dhe domosdoshmerine e nje vendimi penal gjyqesor te formes se prere. Parashikimi i ndryshimeve teresore ne kuptimin e termave te mesiperm tregon me se miri bindjen e ligjberesit mbi domosdoshmerine e ndryshimeve, pavaresisht qe ne opinionin e avokatit edhe keto ndryshime jane ne kundërshtim me te drejten kushtetuese apo ligjin procedural penal dhe posaçerisht, ashtu eshte thene me siper, me parimin e prezumimit te pafajshise. Neni 37 parashikon ndryshime te rendesishme, ne te kundert me ate çfare eshte parashikuar me ligjin e meparshem. Neni 37 fillon me konceptin e pashpjegueshem ne te drejten penale pastrim te produkteve te vepres penale ose veprimtarise kriminale. Me pas, ne piken "ç", parashikohet zbatimi i ketij neni edhe kur per vepren penale nga e cila kane ardhur produktet nuk eshte filluar asnjehere çeshtja penale apo nuk eshte dhene nje denim penal i formes se prere. Ne menyre krejt arbitrare kjo dispozite lejon qe te konsiderohet "veper penale" çdo sjellje apo veprim i dikujt, pa iu nenshtruar normave e rregullave teorike e praktike te se drejtes ne teresi

e posaçerisht të së drejtës penale në veçanti. Kjo është një dispozitë antikushtetuese dhe që cenon rëndë lirite dhe të drejtat themelore të njeriut. Por pavaresisht nga kjo, siç është thënë edhe më sipër, është ky ndryshim i cili tregon që koncepti i parashikuar në ligjin e mëparshëm dhe i arsytuar më sipër ka qenë i drejtë dhe i bazuar në ligj. Nuk mund të kemi kursesi një veprë penale dhe më pas kjo të mos jetë e regjistruar apo e ndeshkuar me anë të një vendimi gjyqësor të formës së prerë. Pavaresisht sa më lart edhe pse është e rëndësishme, avokati theksoi që vepra penale për të cilën akuzohen të pandehurit është kryer në një kohë kur në fuqi ishte neni 287 pa ndryshimet e bëra nga neni 37 i ligjit nr. 23/2012. Në dispozitat kalimtare të ligjit në fjale nuk flitet për fuqinë prapavepruese të këtij ligji në mënyrë të veçantë, si rrjedhojë në rastin tone nuk kemi të bëjmë me fuqi prapavepruese për rastet përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji. Megjithatë edhe në rast të pasjes së fuqisë prapavepruese të ligjit të ri, duhet të thënë që mbështetur në nenin 3 të Kodit Penal mbi veprimin në kohë të ligjit penal, ky ligj është më pak favorizues, në kuptimin e interpretimit të veprës penale, sesa ligji i mëparshëm. Pra, si konkluzion nga ana e Gjykatës duhet të mbahen parasysh parashikimet që pasqyrohen në nenin 287 të ligjit nr. 7895, datë 27.01.1995 “për Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë”.

Avokati u shpreh dhe për provat e prokurorisë, duke filluar me materialet e ardhura nëpërmjet leterporosise nga Greqia. Paraqitja e ketyre materialeve nga ana e Prokurorit është përdorur për të mbështetur konkluzionet e tij për ekzistencën e një veprë penale të denueshme; ekzistencën e veprimeve të kundërligjshme të të pandehurve A dhe S.SH dhe shtrirjen kohore të kryerjes së ketyre veprimeve të kundërligjshme, si dhe ekzistencën e një produkti kriminal të nxjerre nga vepra penale e shfrytëzimit të prostitucionit.

Si gjatë hetimit po ashtu edhe në gjykim, sipas mbrojtjes nga të pandehurit nuk është mohuar fakti që A dhe S.SH po hetohen në shtetin e Greqisë për shfrytëzim të prostitucionit, pastrim parash, etj. në formën e një organizate kriminale. Nga materiali që ka ardhur nga Greqia dhe që prokurori e relatton në cilesinë e provës, rezulton se organet e policisë dhe prokurorisë në Greqi po hetojnë të pandehurit A dhe S.SH për vepra penale të ndodhura nga viti 2006 deri në vitin 2009. Në material bëhet fjale për një vrasje të një shtetasi grek ndodhur në Athinë në fillimin e vitit 2006, ku gjatë hetimit për këtë vrasje ka dalë që në vendin e ngjarjes ka qenë edhe një prostitutë, e cila sipas Prokurorit është shfrytëzuar nga i pandehuri A.SH. Sipas prokurorit i pandehuri A.SH që prej vitit 2006, apo ndoshta edhe më heret në kohë, kishte krijuar një zyre takimesh erotike, ku nëpërmjet saj lidhej me kliente të ndryshëm, të cilët kërkonin të kryenin marrëdhënie seksuale kundërt shpërblimit në para me prostituta që ishin nën kujdestarinë e A.

Në të gjithë materialin e servirur si prova nga prokurori për këtë ngjarje, nuk ka prova të cilat akuzojnë drejtperdrejt apo indirekt të pandehurin A.SH për shfrytëzim të prostitucionit ndaj një shtetaseje të huaj. Pavaresisht se prokurori ka sjelle në pergjithësi materialin në cilesinë e provës shkresore, duhet thënë se në shqyrtimin gjyqësor, duke respektuar qëllimin për të cilin prokurori paraqiti materialin, duhet të merren parasysh të gjitha të dhënat që kanë rezultuar nga hetimi i organeve të drejtësisë greke. Në material ka vetëm deklaramë të disa dëshmitarëve dhe jo akte të tilla që kanë të bëjnë me përkrimin e ngjarjes apo veprimeve të kryera nga organet e drejtësisë greke. Në material mungojnë kqyrja e vendit të ngjarjes, kontrolli i banesave, sekuestrimet e provave, kqyrjet e telefonave e të tjera veprime. Provat përbejnë njoftime mbi faktet e rrethanat që lidhen me veprën penale, që merren prej burimeve të parashikuara nga ligji procedural dhe nuk zëvendësojnë njera-tjetren. Në këtë hetim i pandehuri A.SH është akuzuar për veprën penale të shfrytëzimit të prostitucionit, por që nga viti 2006 deri më momentin e sotëm, organet e drejtësisë greke nuk e kanë dërguar çështjen për gjykim apo të kënaqur vendim përfundimtar, përkundrazi e kanë bashkuar hetimin e kësaj ngjarje me hetimin e vitit 2009. Gjatë periudhës nga viti 2006

deri ne vitin 2009 A.SH ka qene nje person i lire, ai ka hyre dhe ka dale nga Greqia, ka zhvilluar aktivitetet tregtar ne fushen e lundrimit turistik. Ne materialin qe ka te beje me kete vrasje nuk ka asnje te dhene per aktivitetin kriminal te te pandehurit tjetër S.SH.

Sipas Prokurorit ne vitin 2009 ne menyre te papritur, pavaresisht se organet e drejtesise greke mbeshtetur nga te dhenat e materialit po hetonin per aktivitetin kriminal te A.SHt, sherbimet e policise ne Athine kishin informacione qe A dhe S.SH qe prej vitit 2006 ishin drejtues te nje organizate, e cila kishte ne perberje rreth 20 drejtues mjetesh, me kombesi greke dhe te huaj, si dhe 20 prostituta, kryesisht te kombesise te huaj ruse, ukrainase, rumune, si dhe shqiptare, e cila qe merrej me shfrytezim te prostitucionit. Femrat me origjine nga vendet e ish-Bashkimit Sovjektiv kontaktoheshin nepermjet nje agjencie pune ne Rusi. Te pandehurit A e S.SH drejtonin nje zyre takimesh erotike, e cila kishte te publikuar ne gazeta te ndryshme numrat e kontaktit. Klientet pasi merrnin ne keto numra komunikonin me operatore te ndryshme. Keto te fundit pasi merrnin adresen e klientit, komunikonin me drejtuesit e taksive dhe prostitutat, te cilet kishin nje pike takimi te perditshem ne nje lokal. Nje drejtues taksie merrte gjithmone nje prostitute dhe e çonte ne vendin e takimit erotik, ku çmimi ishte rreth 150 euro. Pas mbarimit te takimit drejtuesi i taksise merrte perseri prostituten, e cila merrte shperblimin e saj 20-30 euro. Drejtuesi i taksise merrte shperblimin e tij 20-30 euro, ndersa pjesen tjetër e dorezonte tek nje drejtues taksie kryesor, shtetas grek, i cili nga ana e tij ia dorezonte fitimet e mbremjes te pandehurit S.SH. Me keto te ardhura vellezerit SH. kishin krijuar nje shoqeri lundrimi, argetimi, ku kishin edhe blere edhe pese skafe me vela, te cilat i perdornin edhe si vende te takimeve erotike.

Sipas Prokurorit sherbimet e policise ne fillim te muajit prill te vitit 2009 kane organizuar vezhgimet e lokalit dhe te personave ku mendohej qe ushtrohej veprimtaria kriminale. Vezhgimi ka filluar ne date 03.04.2009 dhe ka vazhduar deri ne date 16.05.2009. Vezhgimi fillonte gjithmone nga nje lokal, ku jane mbajtur te dhenat ne lidhje me mjetet, personat shofere qe drejtonin keto mjete, si dhe femrat qe hipnin ne keto mjete. Vezhgimi vazhdonte duke ndjekur mjetet dhe kthimin e tyre ne lokalin ku kishte filluar vezhgimi. Shoferet dorezonin tek nje shofer shtetas grek parate, te cilat ky i fundit me vone ia dorezonte S.SHt. Nga vezhgimi jane identifikuar disa nga shoferet qe kane qene me kombesi shqiptare, greke, rumune. Ne date 19.05.2009 jane organizuar ne dy raste takime erotike te kontrolluara, ku kliente kane qene dy oficere policie. Ne takim jane paraqitur dy prostituta, te cilat kane thene se vinin nga zyra dhe kerkonin nje shume prej 150 euro paradhenie. Ne keto momente eshte bere ndalimi i prostitutave, njera me kombesi ruse dhe tjetra me kombesi shqiptare, si dhe dy shoferet me kombesi shqiptare.

Organet e policise greke ne vijim te operacionit kane ndaluar 11 shofere taksie, nder ta kater shtetas shqiptare, nje rumun dhe te tjeret me kombesi greke. Te gjithë keta persona kane deklaruar se nuk e dinin emrin e pronarit te zyres. Jane identifikuar pese prostituta, ku nga keto vetem dy kane deklaruar se pronari i zyres e ka emrin A., por kete e kishin mesuar nga shoferet. Te pandehurit, se bashku me persona te tjere, jane akuzuar per shfrytezim te prostitucionit ndaj 37 femrave, shumica me origjine dhe kombesi nga vendet e ish-Bashkimit Sovjektiv, ku vetem kater prostituta jane identifikuar me gjeneralitete te sakta. Ne materialin hetimor flitet per nje agjensi pune ne Rusi me administratore nje shtetase ruse, e cila rekrutonte femrat, por nuk identifikohet identiteti i sakte apo vendndodhja e kesaj agjensie.

Ne lidhje me akuzat ne ngarkim te te pandehurve A e S.SH, jane pyetur disa shtetas greke, te cilet kane patur lidhje dhe marrëdhënie pune me te ta. Shtetasit greke perfaqesojne persona qe kane dhene me qera apo kane shitur skafet dhe qe kane punuar se bashku me S.SHn. Ne keto deklarime S.SH rezulton te kete qene gjithmone i interesuar per lundrimin. Ai ka filluar te lundroje qe rreth vitit 1995, ku fillimisht ka punuar si lundertar dhe me pas ka mbaruar shkollen per lundrimin ne Athine. Ne periudhen e viteve 2001 – 2004, S. ka punuar si

kapiten ne njeren nga shoqerite qe organizonin lundrime turistike dhe ka qene nje nga lundertaret me te afte te Athines. Nje nga deshimtaret, qe eshte pronar restoranti, ka deklaruar se daten kur eshte vezhguar S.SH, duke marre para nga shoferi grek, ky ka qene duke darkuar ne lokalin e tij me njerezit e tij qe i njeh shume mire te gjithë. Shtetasi S.SH ka lundruar per ne ishullin ku ndodhej restoranti ne bordin e njerit nga skafet dhe per kete qellim eshte shenuar edhe ne regjistrat perkates te lundrimit dhe eshte leshuar nje vertetim i tille.

Nga materiali rezulton se i pandehuri S.SH ka qene me masen e sigurimit te arrestit ne burg, por eshte paraqitur vete ne organet e drejtesise greke (masa me pas i eshte hequr), ndersa A.SH nuk ka nje mase te tille. Çeshtja ne ngarkim te tyre nuk eshte derguar akoma per gjykim, pavaresisht se ka kaluar nje periudhe prej rreth kater vjetesh.

Edhe ne lidhje me kete ngjarje mungojne akte procedurale kryesore, te cilat plotesohen vetem nga deklarimet e disa punonjesve te policise se Athines, te angazhuar ne operacionin per ndalimin e personave te permendur me lart. Ne asnje rast nuk ka prova, te drejtperdrejta apo indirekte, te cilat te mbeshtesin ekzistencen e veprimeve kriminale te A e S.S.Ht, te ekzistences te vepres penale, madje ka deklarime nga te cilat rezulton se te pandehurit njihen si njerez te mire, punetore, te edukuar dhe te ndershem.

Prokurori relatoi ne cilesine e proves disa biseda te pergjuara ne telefonat celulare te te pandehurve. Paraqitja nga Prokurori e kesaj prove behet me qellim arritjen e nje konkluzioni mbi ekzistencen e pamjaftueshmerise apo justifikimit pa prova te origjines se pasurise te ardhur nga veprime, te cilat perbejne pastrim te produkteve te vepres penale, si dhe mbi ekzistencen e dijenise apo mundesise per te pasur dijeni nga ana e te pandehurve C.M dhe F.Z ne lidhje me origjinen e vlerave monetare. Sipas Prokurorit te pandehurit gjate periudhes te fillimit te hetimit kane komunikuar me njeri-tjetrin per te kryer veprime, te cilat kishin per qellim justifikimin e shumave ne para te bllokuara ne llogarite bankare. Prokurori pretendon se nga keta persona dhe te tjere jane perpiluar dokumente, te cilat jane transferuar per ne Greqi me qellimin e mesiperm. Nga materiali qe ka ardhur nepermjet leterporosise, nuk rezultoi asnje prove e drejtperdrejte apo indirekte ne lidhje me ekzistencen e ketyre dokumenteve. Avokati theksoi se pergjimet telefonike bejne pjese ne mjetet per kerkimin e proves dhe nuk perbejne prove me vete. Pergjimet telefonike kane vlere si prove deri ne momentin qe ato shoqerohen me proven materiale konkrete te dale nga pergjimet, perndryshe ato mund te vleresohen thjesht komunkime ose "muhabete". Pra nga analiza e ketyre provave nuk rezultojne te dhena ne lidhje me faktet per te cilat akuzohen te pandehurit.

Prokurori relatoi ne cilesine e proves pasqyrat e llogarive bankare ne emer te te pandehurve, te dhena ne lidhje me aktivitetet tregtare, duke arritur ne disa konkluzione. Paraqitja nga prokurori e ketyre provave behet me qellim arritjen e konkluzioneve mbi ekzistencen e origjines te paligjshme te pasurise, mbi ekzistencen e pamjaftueshmerise apo justifikimi pa prova i origjines se pasurise, si dhe mbi ekzistencen e veprimeve te kunderligjshme te kryera nga te pandehurit C.M dhe F.Z. Me qellimin e mesiperm prokurori rendit si prova kohen e krijimit te llogarive bankare pas periudhes te vitit 2005 deri ne vitin 2009, pa patur shpjegim financiar; rritjen e pasurise ne menyre te pazakonshme apo te papritur brenda nje periudhe kohore te shkurter; transfertat bankare te cilat kane si karakteristike perdorimin e nje sasie te madhe te parave kesh; mungesen e nje justifikimi te ligjshem te te ardhurave per te realizuar transaksionet bankare; mungesen apo justifikimin e pabazuar mbi origjinen e ligjshme te transaksioneve bankare; kryerjen e transaksioneve bankare ne menyre te parregullt, depozitim e parave ne banka ne menyre te copezuar, e cila nuk i pergjigjet nje dinamike te aresyeshme, hapjen e llogarive bankare te njepasnjeshme ne intervale te shkurtra.

Ne materialin e ardhur me leterporosi, por edhe ne materialin e mbedhur nga prokurori ne Shqiperi, rezulton se i pandehuri S.SH rreth viteve 2006-2007 ka blere tre skafe fillimisht

per nje vlere prej 1000000 euro, duke paguar nje kapar prej 200000 euro nje shtetasi grek, ndersa pjesen tjetere e kishte per ta paguar me keste per nje periudhe prej 5 vjetesh. Ne kete periudhe S.SH ka marre nje hua nga nje shtetas grek ne shumen prej 150000 euro. Ne fund te vitit 2006 dhe ne fillim te vitit 2007, nje bashkeipandehur me te pandehurit ne kete gjykim ne procesin hetimor ne Greqi, me kombesi greke, duke qene keshilltar administrativ i shoqerise anonime "Shoqeria anonime e rrugeve lundruese te anijeve argetuese", ka kryer disa procedura per tre skafe, qe ishin ne pronesi te kesaj shoqerie. Regjistrimi i kesaj shoqerie ne emer te nje shtetasi grek eshte bere per faktin se A.SH nuk kishte leje pune. Po ne kete periudhe vellezerit SH. kishin aktivitetet te konsiderueshme ne Shqiperi, aktivitetet ne fushen e karburanteve. Gjate kesaj periudhe ka levizje te shumave monetare ne euro nga Shqiperia per ne Greqi me qellim blerjen e skafeve. Ne vitin 2009 te pandehurit SH., se bashku me dy shtetas greke, kane krijuar nje shoqeri me emrin "Rruget lundruese", me nje kapital 2500000 euro, me qellimin per te blere skafet e shoqerise "Shoqeria anonime e rrugeve lundruese te anijeve argetuese", te cilet ne fakt ishin ne pronesi te vellezerve SH.. Kjo shoqeri figuronte ne emer te nje shtetasi grek, pasi sipas legjislacionit grek nuk lejohej krijimi i nje shoqerie nga shtetas jogleke. Ne materialin e ardhur nepermjet leterporosise jane tre vertetime per regjistrimin e tre skafeve nga shoqeria anonime, te dates 29.03.2007, ku jepen te dhena teknike ne lidhje me skafet. Po nga ky material rezulton qe shoqerite kane patur aktivitetet tregtar dhe bilanc pozitiv ne shuma te konsiderueshme. Duke analizuar mbi provat e akuzes, avokati theksoi se nga natyra e transakcioneve te llogarive bankare, nuk mund te nxirren konkluzionet, ne te cilat del prokurori, pasi te pandehurit nuk kane patur statusin e nje qytetari te thjeshte, por ata kane qene biznesmene me pasuri te konsiderueshme dhe te ardhura te konsiderueshme. Prokurori ne diskutimin perfundimtar nuk eshte ndalur ne analizen e veprimtarive tregtare dhe prodhuese te te pandehurve C.M dhe F.Z, te cilet kane patur aktivitetet tregtare dhe te ardhura te konsiderueshem, kjo e bazuar edhe ne prova te sjella nga ata gjate hetimit.

Mosmarrja ne konsiderate nga ana e prokurorit e aktivitetit te gjere te biznesit qe vellezerit SH. kane patur, si dhe aktualisht kane si ne Greqi, ashtu edhe ne Shqiperi, eshte absurde. Vetem ne Shqiperi ushtrojne aktivitetin biznesi ne fushen e tregtimit te karburanteve ne dy pika shitje, njera prej te cilave ndodhet ne mes te autostrades Vore-Tirane dhe tjetra ne Berat. Po ashtu ne pronesi te tyre jane disa hektare toke me sera diellore te cilat administrohen nga babai i tyre, si dhe miku i tyre F.Z.

Prokuroria nuk ka marre ne konsiderate as prova shpresore te rendesishme qe vertetojne prejardhjen e nje pjese te konsiderueshme te pasurise qe eshte objekt i ketij gjykimi, siq jane disa kontrata dhe deklarata noteriale, te bera shume kohe perpara se ndaj vellezerve SH. te fillonte procedimi penal, apo deklarata e Kryetarit te Komunes, si dhe e bashkepunetoreve te tyre ne biznes, etj.

Prokuroria ne menyre te padrejte dhe te gabuar eshte investuar ne krijimin e ketij procesi penal, pasi nje proces i tille, me te njejtin objekt, ndaj te njejteve persona, ka filluar ne shtetin grek dhe megjithese ka rreth kater vjet qe kane filluar hetimet, nuk ka ende asnje konkluzion te sakte, pasi krejt procesi ka qene nje intrige dhe montim ne dem te vellezerve SH., per arsye xhelozie biznesi, nga nje shtetas grek, ne emer te te cilit kishin regjistruar aktivitetin e tyre te biznesit, biznes i cili ne vitin 2011 ka kaluar krejtesisht ne emer te A.SHt.

Perfundimisht, duke iu referuar analizes te mesiperme, si dhe duke u mbeshtetur ne nenin 388, pika "a" te Kodit te Procedures Penale, avokati i kerkoi Gjykates te deklaroje te pafajshem te pandehurit A.SH; S.SH; C.M dhe F.Z, pasi faktet per te cilat ata akuzohen nuk perbejne veper penale, pasi nuk ekzistojne. Gjithashtu ai kerkoi nga Gjykata qe ne mbeshtetje te nenit 36 te Kodit Penal, heqjen e sekuestros preventive vendosur me vendimin nr. 987 akti, dt.26.05.2009 te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane, vendimin nr. 996 akti, dt.27.05.2009 te

Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane, si dhe me vendimin e dt. 27.05.2009, te prokurorit, mbi llogarite e te pandehurve.

Siç eshte permendur edhe me lart, te pandehurit A e S.SH nuk u paraqiten ne gjykim me vullnetin e tyre, ndersa te pandehurit C.M e F.Z moren pjese ne disa séanca gjyqesore, por nuk u paraqiten ne séancen e fundit.

Sa me siper u provuan gjate gjykimit me provat shkresore te cilat ndodhen ne fashikull dhe u moren ne seance gjyqesore, si dhe me shpjegimet e paleve.

Duke u bazuar ne provat e mesiperme, te marra gjate shqyrtimit gjyqesor, gjykata arrin ne perfundimin se akuza e ngritur ndaj te pandehurve nuk eshte e bazuar. Nuk rezultoi i provuar plotesisht, jashte çdo dyshimi, fakti se te pandehurit, ne bashkepunim me njeri tjetrin, kane kryer vepren penale te parashikuar nga neni 287 i KPenal.

Organi i prokurorise eshte bazuar ne faktin se ndaj te pandehurve A e S.SH ka filluar e po vazhdon ne Greqi nje procedim penal, ku ata akuzohen per vepra penale te ngjashme me ato te parashikuara ne Kodin Penal te Republikes se Shqiperise, si shfrytezimi i prostitucionit, pastrimi i parave, etj. Vete prokurori pranon se ky procedim penal ne Greqi eshte ne fazen e hetimeve paraprake e megjithese kane kaluar disa vjet nga fillimi i hetimeve, çeshtja nuk eshte derguar akoma per gjykim. Pra jo vetem qe nuk kemi ndonje vendim gjyqesor penal te formes se prere, me te cilin jane denuar te pandehurit, por gjykimi ndaj tyre ne Greqi (nese do te kete ndonjehere te tille), nuk ka filluar ende. Megjithate sipas prokurorit te pandehurit e kane kryer vepren penale pastrimi i produkteve te vepres penale, parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal, pasi ne bashkepunim me njeri tjetrin, kane nxjerre perfitime, duke kryer vepra penale dhe me pas kane pastruar produktet e vepres penale, duke i futur parate e fituara ne menyre te paligjshme ne qarkullimin civil, duke i investuar apo duke i depozituar ne banka. Prokurori eshte bazuar kryesisht ne materialet e ardhura nga Greqia, ne baze te nje leterporosie te kerkuar nga ky organ. Nga ky material rezulton qe ne Athine ka ndodhur vrasja e nje shtetasi grek dhe ne shtepine ku ka ndodhur ky krim eshte gjetur nje prostitute, e cila sipas akuzes shfrytëzohej nga i pandehuri A.SH. Kjo ngjarje eshte bere shkas per fillimin e nje procedimi penal, i cili siç eshte permendur edhe me lart, jo vetem nuk ka perfunduar, por çeshtja nuk ka shkuar akoma per gjykim. Prokurori i perdor materialet e ardhura me leterporosi, per te mbeshtetur akuzen, sipas se ciles ekziston nje veper penale ne Greqi, e kryer nga A e S.SH. Kjo veper eshte kryer prej ketyre te pandehurve, te cilet me veprimet e tyre te kunderligjshme, kane ushtruar nje veprimtari kriminale per disa vjet, duke shfrytëzuar prostituta dhe duke nxjerre ne kete menyre fitime te medha ne menyre te paligjshme. Gjithnje sipas prokurorit, keto fitime te pandehurit A e S.SH, ne bashkepunim me njeri tjetrin, si dhe me te pandehurit C.M e F.Z, i kane futur ne qarkullim civil, duke i investuar e duke i depozituar neper banka. Ne kete menyre te kater te pandehurit, ne bashkepunim me njeri tjetrin, duke pastruar produktet e vepres penale, sipas prokurorit kane kryer vepren penale te parashikuar nga neni 287 -25 i KPenal.

Te pandehurit nuk e kane mohuar faktin se po hetohen ne Greqi, per shfrytëzim prostitucioni, pastrim parash, etj., ne formen e organizates kriminale. Gjithashtu te pandehurit kane pranuar, si gjate hetimit, ashtu dhe gjate gjykimit, se merren me veprimtari private, per me teper te sukseshme, si ne Greqi, ashtu edhe ne Shqiperi. Por nga materiali i ardhur me leterporosi, si dhe nga provat e tjera, nuk del asnje fakt, i cili te perbeje veper penale. Eshte e vertete qe te pandehurit kane bere investime, kane depozituar shuma te konsiderueshme neper banka, kane kryer transferta bankare, etj., por keto jane veprime te zakonshme per çdo person qe merret me biznes brenda apo jashte vendit. Fakti qe ne Greqi po zhvillohet nje procedim penal, ku flitet per shfrytëzim prostitutash, per perdorje shoferesh taksie e zyresh per kete qellim, per njoftime per numra telefonike me ane te te cilave siguroheshin takime erotike, te cilat ne fakt ishin marrëdhënie seksuale me prostituta, kundrejt shperblimit, etj., nuk provon

se parate e investuara e te depozituara nga te pandehurit jane produkt i nje vepre penale. Vete fakti se megjithese kane kaluar disa vjet, organet e hetimit ne Greqi nuk e kane perfunduar hetimin dhe nuk e kane derguar çeshtjen ne gjyq, tregon me se miri se nuk ka patur prova per te provuar nje veprimtari kriminale, pra kryerjen e veprave penale, qofte nga te pandehurit ne kete gjykim, qofte nga te pandehur te tjere. Prokurori pa te drejte e konsideron fakt te kryer ekzistencen e nje vepre penale, vetem se ne Greqi ka filluar nje procedim penal. Per me teper prokurori arrin ne perfundimin se parate e investuara e te depozituara nga te pandehurit jane produkt i kesaj apo ketyre veprave penale, te cilat siç eshte permendur edhe me lart, nuk eshte provuar akoma nese jane kryer, apo jo. Nje fakt tjetër qe eshte kunder akuzes eshte edhe fakti se te dy te pandehurit SH. nuk jane te arrestuar, por hetohen ne gjendje te lire. Nese do te ishte i vertete fakti se ata kane kryer vepra penale ne kuadrin e nje organizate kriminale, pra nese do te kishte prova per kete, ndaj tyre do te ishin marre masa shtrenguese sipas ligjit. Nuk ka prova te drejteperdrejta apo indirekte, te cilat te provojne se te pandehurit A e S.SH kane kryer vepra penale. Gjithashtu mungojne aktet procedurale. Ka vetem deklarime te disa punonjesve te policise se Athines. Prokurori bazohet vetem ne disa biseda te pergjuara telefonike, me ane te te cilave eshte perpjekur te mbushe boshllekun nga mungesa e provave. Me ane te ketyre bisedave te pergjuara prokurori perpiqet te provoje ekzistencen e pamjaftueshmerise, apo mosjustifikimit me prova te origjines se pasurise se te pandehurve, e cila sipas tij ka ardhur nga veprime te cilat perbejne pastrim te produkteve te vepres penale. Prokurori perpiqet te provoje edhe ekzistencen e dijenise apo mundesise per te patur dijeni, nga te pandehurit C.M e F.Z, ne lidhje me origjinen e pasurise, e cila ka ardhur si rezultat i pastrimit te produkteve te vepres penale, te faktit se te pandehurit kane komunikuar me njeri tjetrin per te kryer veprime te cilat kane patur si qellim justifikimin e shumave ne para te bllokuara ne llogarite bankare, si dhe te faktit se ata dhe persona te tjere kane perpiluar dokumente te cilat jane transferuar ne Greqi per kete qellim. Nuk ka asnje prove qe te vertetoje keto fakte. Gjithashtu pergjimet telefonike jane mjet per kerkimin e proves dhe nuk perbejne prove. Me te drejte mbrojtja thekson se pergjimet telefonike kane vlere vetem kur shoqerohen me proven materiale konkrete te dale nga ato.

Prokurori eshte perpjekur te provoje akuzen me pasqyrat e llogarive bankare ne emer te te pandehurve, te dhena ne lidhje me aktivitetet tregtare e ka arritur ne konkluzione te pabazuara. Qellimi i prokurorit ka qene qe te arrije ne konkluzionet se ekziston origjina e paligjshme e pasurise se te pandehurve, ka pamjaftueshmeri dhe justifikim pa prova i origjines se pasurise, si dhe ka veprime te kunderligjshme te kryera nga te pandehurit C.M e F.Z. Prokurori rendit si prove kohen e krijimit te llogarive bankare pas vitit 2005 e deri ne vitin 2009, pa patur shpjegim financiar, rritjen e pasurise ne menyre te pazakonshme apo te papritur, transfertat bankare ne shuma te madha, mungesen e nje justifikimi te ligjshem te te ardhurave, mungesen apo justifikimin e pabazuar te origjines se transaksioneve bankare, kryerjen e transaksioneve ne menyre te parregullt, depozitimin e parave ne banka ne menyre te copezuar, hapjen e llogarive bankare ne intervale te shkurtera. Konkluzionet e prokurorit per keto fakte jane te pabazuara. Ai nuk ka marre parasyshe edhe vete materialin e ardhur me leterporosi, perveç faktit se te pandehurit kane patur aktivitet si ne Shqiperi ashtu edhe ne Greqi. Nga materiali i leterporosise rezulton se S.SH ka blere tre skafe, si dhe ka marre hua nga nje shtetas grek. Provohet gjithashtu se „Shoqeria anonime e rrugeve lundruese te anijeve argetuese“ e vellezerve SH. eshte regjistruar ne emer te nje shtetasi grek, per shkak se nuk lejohej te regjistrohej ne emer te tyre, pasi ishin shtetas shqiptare. Ky fakt provohet pasi tashme vellezerit SH. e kane shoqerine edhe ligjerisht ne pronesine e tyre. Gjate kesaj kohe vellezerit SH. kane patur aktivitet te madh edhe ne Shqiperi. Ne vitin 2009 vellezerit SH. se bashku me dy shtetas greke kane krijuar nje shoqeri me emrin „Rruget Lundruese“, me nje kapital 2500000 euro, me qellim per te blere skafet e shoqerise se permendur me lart, e cila

ishite ne fakt ne pronesi te vellezerve SH.. Ka patur levizje te shumave monetare per blerjen e skafeve e per aktivite te tjera. Edhe ne materialin e ardhur me leterporosi jane vertetimet per regjistrimin e skafeve. Gjithashtu nga ky material rezulton qe shoqerite kane patur aktivitet tregtar e bilanc pozitiv ne shuma te konsiderueshme. Prokurori nuk ka analizuar kete veprimtari, ashtu si nuk ka analizuar dhe veprimtarine tregtare e prodhuese te te pandehurve C.M e F.Z, te cilet kane patur aktivitet e te ardhura te konsiderueshme, fakte keto te provuara plotesisht. Pra prokurori, pa analizuar aktivitetin e te pandehurve (ne Greqi e ne Shqiperi), ka dale ne perfundimin e pabazuar se origjina e pasurise ka ardhur si rezultat i produktit te nje vepre penale, e cila siç eshte permendur edhe me lart, nuk vertetohet nese eshte kryer apo jo. Te pandehurit me te drejte pretendojne sene aktivitetet e tyre tregtare e prodhuese kane fituar shuma te konsiderueshme te hollash ne menyre te ligjshme. Organi i akuzes nuk ka marre ne konsiderate prova shkresore qe vertetojne prejardhjen e nje pjese te konsiderueshme te pasurise se te pandehurve. Mjaft nga keto prova shkresore jane bere shume kohe perpara se te fillonte procedimi penal.

Me te drejte te pandehurit theksojne faktin se ne shtetin grek nuk ka asnje konkluzion te sakte, megjithese ka rreth kater vjet qe kane filluar hetimet. Kjo tregon se procesi mund te kete qene i stisur, intrige e montim, ne dem te vellezerve SH., per arsye xhelozie, apo konkurrence biznesi. Nje nga nxitetit mund te kete qene shtetasi grek ne emer te te cilit kishin regjistruar aktivitetin vellezerit SH., biznes i cili ne vitin 2011 ka kaluar krejtesisht ne emer te A.Sht. Gjithashtu duhet permendur edhe fakti i mostrajtitim njelloj nga organet proceduese greke te shtetasve shqiptare e atyre greke.

Sipas prokurorit mjafton te provohet ne menyre te pakundershtueshme qe vepra penale kryesore, apo krimi fillestar eshte kryer, por nuk eshte e nevojshme qe te kemi nje vendim gjykate per kete krim fillestar, duke mos e konsideruar te rendesishem edhe identifikimin e autoreve te krimit fillestar. Ne rastin konkret, duke e konsideruar vepren penale fillestare te kryer, prokurori arrin ne perfundime te pabazuara se origjina e pasurise te te pandehurve eshte produkt i kesaj vepre penale. Gjykata çmon se nuk eshte provuar kryerja e vepres penale ne Greqi. Gjithashtu nuk provohet se origjina e pasurise te te pandehurve eshte produkt i ndonje vepre penale. Perkundrazi provohet plotesisht se te pandehurit kane aktivitet te sukseshem si ne Greqi ashtu dhe ne Shqiperi, gje qe ka sjelle fitime, te cilat jane depozituar ne banka dhe jane investuar. Sipas nenit 287 te KPenal, si dhe sipas Konventes se Varshaves, ekziston termi pastrim i produkteve te vepres penale. Kjo do te thote se duhet te kemi nje veper penale. Ne rastin konkret nuk kemi veper penale e cila provohet se eshte kryer, ku eshte kryer dhe nga kush eshte kryer. Vetem kur kemi nje vendim gjyqesor te formes se prere, kemi prove te plote se eshte kryer vepra penale.

Prokurori nuk ka vepruar drejt ne zbatimin e nenit 36 te KPenal, pikerisht paragrafin 3 te ketij neni. Nuk eshte bere asnje hetim, apo analize per te ndare pasurine qe sipas prokurorit ka ardhur si produkt i vepres penale, nga pasuria e ligjshme e te pandehurve. Provohet se te pandehurit kane aktivitet e prona te ndryshme, pra kane pasuri te ligjshme. Siç eshte permendur edhe me lart, si ne Kodin Penal, ashtu dhe ne Konventen e Varshaves, termi eshte produkt i ardhur nga vepra penale. Prokurori perdor pa te drejte terma si krim fillestar, apo aktivitet kriminal i paligjshem. Sipas ligjit, doktrines dhe praktikës gjyqesore, per te patur nje veper penale, perveç faktit se ka nje veprim apo sjelle njerezore te kunderligjshme, duhet te kemi kater elementet e vepres penale. Edhe njeri sikur te mungoje nuk kemi veper penale e per pasoje, as pastrim te produkteve te vepres penale. Pra duke u bazuar ne Konventen e Varshaves, e cila ka termin veper penale kryesore, e cila nenkupton çdo veper penale qe ka sjelle produkte, qe te ekzistojte kjo veper, e si pasoje edhe ajo e parashikuar nga neni 287 i KPenal, duhet te kemi te kater elementet e vepres penale. Ne rastin konkret nuk eshte provuar ekzistenca e vepres penale ne Greqi, me te kater elementet e saj te domosdoshem, pra nuk

mund të kemi veprën penale të parashikuar nga neni 287 i KPenal. Por edhe po të kishim veprën penale në Greqi (gje që siç është përmendur më lart nuk provohet), nuk provohet se origjina e pasurisë së të pandehurës është produkt i një veprë penale. Përkundrazi provohet se të pandehurit kanë një aktivitet të suksesshem.

Po të merret për bazë pretendimi i prokurorit se mjafton të provohet ekzistenca e krimit fillestar, madje edhe në mungesë të një vendimi gjykate, do të veprohej në kundërshtim me parimin e prezumimit të pafajësisë, neni 4 i KPPenale. Prokurori, duke pretenduar se shumata në llogaritë bankare janë rrjedhojë e aktivitetit kriminal të zhvilluar në Greqi, prezumon se të pandehurit janë fajtorë për veprën penale për të cilën akuzohen, gje që është në kundërshtim me nenin 4 të KPPenale.

Në rastin e veprës penale të parashikuar nga neni 287 i KPenal nuk jemi përpara rastit të mosjustifikimit të venies së pasurisë me burime të ligjshme. Në rastin e nenit 287 të KPenal barra e provës i takon prokurorit. Nuk mund të prezumohet fajtor i pandehuri, mbi bazën e justifikimit të pabazuar të origjinës së pasurisë. Gjykimi penal zhvillohet si pasoje e rregullave të percaktuara qartë në KPPenale. Edhe kur të pandehurit akuzohen sipas nenit 287 të Kpenal, gjykimi zhvillohet sipas këtyre rregullave. Prezumohet pafajësia e të pandehurit dhe barra e provës për vertetimin e akuzës i bie prokurorit. Në rastin konkret akuza e prokurorit mbështetet mbi dyshime, të cilat në bazë të nenit 4 të KPPenale shkojnë në favor të të pandehurit. Nuk është i drejtë pretendimi i prokurorit se mjafton që i pandehuri të akuzohet për kryerjen e një veprë penale dhe të kemi një pasuri e cila ka një origjinë të dyshimte e jo të justifikuar ligjrisht, që i pandehuri të akuzohet për veprën penale të parashikuar nga neni 287 i Kpenal, megjithatë nuk është provuar a gjykuar ekzistenca e veprës penale fillestare.

Në përfundim të shqyrtimit gjyqësor gjykata është e vetmja që vendos nëse ekziston vepra penale dhe ka të gjetur elementet e duhur për tu quajtur e tillë, nëse i pandehuri është fajtor për kryerjen e veprës penale, si dhe nëse produkti i ardhur nga vepra penale duhet të konfiskohet. Në rast se një person deklarohej i pafajshëm me vendim gjykate, atëherë pasuria e tij nuk i nënshtrohet konfiskimit sipas nenit 36 të KPenal. Në gjykimin penal është e domosdoshme lidhja shkak – pasoje, veprën penale - produkt, deklarimi fajtor - konfiskimi i pasurisë.

Në legjislacionin shqiptar është miratuar ligji nr. 10192, dt. 03.12.2009. për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nepermjet masave parandaluese kundër pasurisë. Ky ligj përben një përjashtim nga rregulli mbi të drejtën e pronësisë të personit dhe kjo për një kategori të caktuar veprash penale, të konsideruar nga ligji me pasoja më të rënda në jetën e shoqërisë shqiptare. Ky ligj ka karakter parandalues dhe jo të denimit penal, si dhe zbatohet ndaj pasurive të personave të dyshuar për kryerjen e një kategorie veprash penale, ku dyshimi bazohet në indicie. Ky ligj nuk ka për qëllim denimin e personave për kryerjen e veprave penale, por konfiskimin dhe sekuestrimin e pasurive të personave të cilët dyshohen se kanë kryer një kategori të caktuar veprash penale. Hetimi dhe gjykimi sipas këtij ligji plotësohet nga rregullat e KPCivile. Përjashtimisht nga gjykimet penale, barra e provës bie edhe mbi personin e dyshuar, pronar apo posedues i pasurisë. Ky person ka barrën e provës, për të provuar se pasuria e tij është e ligjshme dhe vjen nga burime jo të ndaluara. Në kundërshtim nga ky ligj, kur kemi të bëjmë me një procedim penal, konfiskimi apo sekuestrimi i bëret sipas KPPenale apo KPenal merr fuqi të plotë vetëm pas dhenies së vendimit. Nëse organi i prokurorisë do të kishte dyshime mbi origjinën e pasurisë së të pandehurës mund të kishte vepruar, apo mund të veprohej në bazë të ligjit nr. 10192, dt. 03.12.2009. Por në këtë gjykim zbatohen rregullat e percaktuara në KPPenale e në KPenal.

Duke qenë se nuk provohet nepermjet një vendimi gjyqësor të formës së prerë ekzistenca e një veprë penale, si dhe fajësia e të pandehurit, pra nuk kemi të bëjmë edhe me

pastrim te produkteve te vepres penale, nuk mund te ekzistojë edhe dijenia apo mundësia për të patur dijeni e personave të tjerë, në lidhje me origjinën e pasurisë që rrjedh nga vepra penale. Për këtë shkak nuk mund të akuzohen të pandehurit F.Z e C.M.

Në favor të të pandehurve është edhe fakti se me ligjin nr. 23/2012, dt. 01.03.2012, neni 37, është ndryshuar neni 287 i KPenal. Ky ndryshim në përmbajtjen e tij ka pranuar arsyetimin e bërë me siper në këtë vendim mbi fajesinë e të pandehurit, nisur nga koncepti i vepres penale kryesore e domosdoshmeria e një vendimi gjyqësor penal të formës së prere. Pavarësisht pretendimeve të mbrojtjes se këto ndryshime mund të jenë në kundërshtim me Kushtetutën e Shqipërisë, gjykata çmon se këto ndryshime tregojnë qartë se me formulimin e mëparshëm të nenit 287, nuk mund të kemi vepra penale të parashikuar nga ky nen, pa patur më parë një vendim gjyqësor penal të formës së prere për veprën penale kryesore, pra për atë vepra penale produktet e të cilës kerkohen të pastrohen. Të pandehurit akuzohen se e kanë kryer veprën penale përpara ndryshimeve të Kodit Penal të përmendura më lart. Në bazë të nenit 3/3 të Kpenal, kur ligji i kohës kur është kryer vepra penale dhe ligji i mëvonshëm janë të ndryshëm, zbatohet ai ligj, dispozitat e të cilit janë me të favorshme për personin që ka kryer veprën penale. Pra gjykata çmon se në rastin konkret duhet të aplikohet ligji i kohës kur pretendohet nga prokurori se është kryer vepra penale, para nenit 287 i Kodit Penal përpara ndryshimeve.

Siç është përmendur edhe më lart akuza në ngarkim të të pandehurve nuk është e bazuar në ligj e në prova. Prokurori ka përshkruar një veprimtari me prostituta, shofere, operatore telefonike, etj., që zhvillohej në Greqi. Gjate kësaj veprimtarie ka ndodhur dhe vrasja e një shtetasi grek. Nuk ka ndonjë çështje penale të perfunduar për këtë veprimtari, pra nuk dihet nëse ka apo jo ndonjë vepra penale. Për pasoje nuk mund të arrihet në konkluzionin se ka pastrim të produkteve të vepres penale. Fakti se ndonjë prostitute, apo ndonjë operatore kanë përmendur emrin e S.SH apo të A., se drejtonin këtë veprimtari, nuk e bën gjykatën të arrijë në konkluzione, të cilat drejtësia greke ka rreth katër vjet e nuk i ka arritur akoma. Prokurori nuk ka analizuar veprimtarinë ekonomike të të pandehurve, për të parë nëse ka pasuri të ligjshme të të pandehurve, të depozituar në banka apo të investuara. Gjithsesi organi i prokurorisë i ka të gjitha mundësitë që nëse dyshon mbi origjinën e paligjshme të të pandehurve, të veprojë në bazë të ligjit nr. 10192, dt. 03.12.2009, duke e konfiskuar apo sekuestruar pasurinë e tyre, apo një pjesë të saj, nëse nuk justifikohet origjina e ligjshme e pasurisë. Të pandehurit kanë patur aktivitet të suksesshëm në Shqipëri e Greqi dhe fitimet (edhe sipas leterporosise rezultojnë se kanë patur fitime të mëdha) i kanë investuar, apo i kanë depozituar në banka. Provohet me prova shprehëse se të pandehurit kanë patur aktivitet e pasuri si në Greqi ashtu dhe në Shqipëri. Në këto kushte është normale që ata të depozitonin para nëprer banka, të blinin e të shisnin pronë, të benin transferta, etj. Këto fakte nuk mund të ngarkojnë të pandehurit me përgjegjësi penale. Vetë prokurori pranon se të pandehurit kanë aktivitete tregtare, shërbimesh e prodhimi, të regjistruara si në Shqipëri ashtu dhe në Greqi. Gjithashtu siç është analizuar edhe më lart edhe nga përgjimet nuk provohet ndonjë fakt kriminal i kryer nga të pandehurit.

Siç është përmendur edhe më lart nuk mund të kemi vepra penale të parashikuar nga neni 287 i KPenal, pa patur veprën penale kryesore të provuar plotësisht se ekziston. Kjo ekzistence, duke u bazuar në nenin 287 të KPenal, mund të jetë vetëm në një vendim penal të formës së prere, përveç ndonjë rasti përjashtimor, për shembull neqoftese i pandehuri vdes gjatë gjykimit dhe çështja pushohet. Nuk provohet se ekziston vepra penale e kryer në Greqi nga shtetasi A e S.SH, siç pretendohet nga prokurori. Pra nuk mund të kemi pastrim produktesh të vepres penale nga këta të pandehur, pasi nuk kemi vepra penale. Për këtë shkak të pandehurit C.M e F.Z nuk mund të akuzohen se kanë patur dijeni, apo kanë patur mundësi të kenë dijeni për veprën penale dhe për pastrimin e produkteve të saj, pasi nuk ka

veper penale dhe as pastrim te produkteve te saj. Perkundrazi te pandehurit kane ushtruar aktivitet normal e kane patur fitime.

Prokurori perdor termin se te pandehurit C.M e F.Z, duke ditur apo duhet te kishin supozuar, per te treguar keshtu se keta dy te pandehur e kane ditur dhe me dashje kane ndihmuar per pastrimin e produkteve te vepres penale. Gjykata çmon se te pandehurit nuk mund te deklarohen fajtores me supozime.

Gjithashtu prokurori pa te drejte arrin ne konkluzionin se nuk duhet domosdoshmerisht si ne rastin e veprave te tjera penale, te provohet lidhja ndermjet vepres penale kryesore dhe pastrimit te produktit te kesaj vepre penale. Per prokurorin mjafton qe te konkludoje per ekzistencen e nje krimi fillestar, si dhe per mundesine e nxjerrjes se nje produkti kriminal, qe te kemi nje mekanizem te krijimit te nje pasurie te paligjshme dhe keto veprime te konsiderohen pastrim i produkteve te vepres penale.

Gjithashtu nuk qendron pretendimi i prokurorit se per personat e trete nuk kerkohej njohuri e percaktuar mbi ekzistencen e krimit fillestar, po mjafton te ekzistojte vetedija, apo te prezumohet dijenia ne lidhje me transakcione financiare jo normale, qe te arrihet ne perfundimin se produkti ka rrjedhur nga nje veper penale.

Akuza ne kete gjykim per fajesine e te pandehurve bazohet mbi dyshime, te cilat ne baze te nenit 4 te KPPenale çmohen nga gjykata ne favor te te pandehurit.

Sa per pretendimin e avokatit se ndryshimet e bera ne nenin 287 te KPenal jane antikushtetuese, gjykata nuk i merr parasysh. Gjykata bazohet ne te gjitha legjislacionin ne fuqi, pra edhe ne nenin 287 te KPenal te ndryshuar. Por ne rastin konkret ne baze te nenit 3/3 te KPenal do te bazohet ne nenin 287 te KPenal perpara ndryshimeve.

Prokurori ka pretendimin e pa bazuar ne ligj se jemi perpara nje fakti kriminal, duke pershkruar si fakt kriminal hapjen e llogarive bankare dhe transfertat bankare te te pandehurve. Eshte e vertete qe fakti ekziston, pasi te pandehurit duke u marre me aktivite te ndryshme kane çelur llogari bankare dhe kane kryer transfertat bankare. Por ky fakt siç eshte arsyetuar edhe me lart, nuk perben veper penale. Per kete shkak te pandehurit duhet te deklarohen te pafajshem, ne baze te nenit 388/b te KPPenale.

Organi i prokurorisë i ka akuzuar te pandehurit se e kane kryer vepren penale te bashkepunim. Bashkepunim sipas nenit 25 te KPenal quhet kryerja e vepres penale nga dy ose me shume persona me marreveshje midis tyre. Gjate gjykimit nuk u provua se ka patur ndonje marreveshje ndermjet te pandehurve. Nuk provohet te kete marreveshje as te meparshme, as te çastit, as me shkrim e as me goje. Gjithashtu nuk ka ndonje prove apo indicie, e cila te te shtyje te besosh se ka patur ndonje marreveshje te heshtur ndermjet te pandehurve. Vepra penale e parashikuar nga neni 287 i KPenal, duke mos qene nje veper penale e thjeshte, qe te kryhet ne bashkepunim, kerkon patjeter marreveshje, e cila nuk u provua gjate gjykimit. Gjithashtu prokurori nuk ka percaktuar dhe rolin e secilit prej te pandehurve gjate vepres penale, pra kush ka luajtur rolin e organizatorit, ekzekutorit, shtytesit e ndihmesit.

Pra fakti i pretenduar nga prokurori si fakt kriminal nuk perben veper penale, gjate gjykimit nuk u provua as ekzistenca e vepres penale kryesore e as pastrim produktesh i ndonje vepre penale. Gjithashtu nuk u provua se te pandehurit kane vepruar ne bashkepunim me njeri tjetrin per te kryer veper penale. Per kete shkak, duke mos patur veper penale, pasi fakti nuk perben veper penale, te pandehurit duhet te deklarohen te pafajshem, ne baze te nenit 388/b te KPPenale. Per rrjedhoje pasuria e te pandehurve, e sekuestruar me vendime gjyqesore e me vendim te prokurorit, duhet tu kthehen atyre ne baze te nenit 275/1 te KPPenale.

PER KETO ARSYE:

Gjykata ne baze te neneve 384, 388/1/b, 274 dhe 275 te KPPenale:

VENDOSI:

- Deklarimin e pafajshem te te pandehurit A.SH, akuzuar per kryerjen e vepres penale te pastrimit te produkteve te vepres penale, kryer ne bashkepunim, parashikuar nga neni 287-25 i Kodit Penal.
- Deklarimin e pafajshem te te pandehurit S.SH, akuzuar per kryerjen e vepres penale te pastrimit te produkteve te vepres penale, kryer ne bashkepunim, parashikuar nga neni 287-25 i Kodit Penal.
- Deklarimin e pafajshem te te pandehurit C.M, akuzuar per kryerjen e vepres penale te pastrimit te produkteve te vepres penale, kryer ne bashkepunim, parashikuar nga neni 287-25 i Kodit Penal.
- Deklarimin e pafajshem te te pandehurit F.Z, akuzuar per kryerjen e vepres penale te pastrimit te produkteve te vepres penale, kryer ne bashkepunim, parashikuar nga neni 287-25 i Kodit Penal.
- Ne baze te neneve 274 e 275 te KPPenale urdherohet heqja e sekuestros preventive vendosur me vendimin nr. 987 akti, dt.26.05.2009 te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane, vendimin nr. 996 akti, dt.27.05.2009 te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane, si dhe me vendimin e dt. 27.05.2009, te prokurorit, mbi llogarite e te pandehurve:
 1. Llogaria ne Leke nr. (.....), ne banken Intesa San Paolo, ne emer te shtetasit A SH.
 2. Llogaria ne USD, (.....), ne banken Intesa San Paolo, ne emer te shtetasit A SH.
 3. Llogaria ne Euro, nr.(.....), ne banken Intesa San Paolo, ne emer te shtetasit A SH.
 4. Llogaria ne Euro, nr. (.....), ne banken Intesa San Paolo, ne emer te shtetasit A SH..Llogaria ne Euro, nr. (.....), ne banken Intesa San Paolo, ne emer te shtetasit C. A.M .
Llogaria ne Euro, nr. (.....), ne banken Intesa San Paolo, ne emer te shtetasit S A SH. (me mbajtes te dyte shtetasin F.Z).
Llogaria ne Euro, nr. (.....), si dhe te gjithë llogarite bankare dhe depozitat me afat te hapura mbi bazen e kesaj llogarie, ne Alpha Bank ne emer te shtetasit C. A.M .
Llogaria ne Euro, me numer klienti (.....), me numer depozite me afat (.....), ne banken Intesa San Paolo, ne emer te shtetasit A A SH.
- Ne baze te neneve 190 e 226 te KPPenale, asgjesimin e CD-ve, ne te cilat jane te regjistruara bisedat e pergjuara telefonike, si dhe pergjigjet nga kompanite e telefonise celulare, sipas vendimit te prokurorit per bashkimin e provave, kur ky vendim te kete marre forme te prere.
- Shpenzimet proceduriale siç jane bere.
- Kunder ketij vendimi lejohet ankim ne Gjykatën e Apelit Tirane brenda 10 diteve, duke filluar ky afat nga e nesermja e shpalljes.
- U shpall sot, ne daten 23.05.2012, ne Tirane.

SEKRETARE
Entela SH.

GJYQTAR
Petrit Çomo